



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 1 regjistër (JR)
Datë 05.01.2022

Nr. 8 i vendimit
Datë 30.01.2025

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Rezarta Schuetz	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 30.01.2025, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 1/2022 (JR), datë 05.01.2022, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Klorinda Çela, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 464, datë 28.10.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Klorinda Çela.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni F i Aneksit të Kushtetutës; nenet 63 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”; neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave

administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi kërkimet e pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Klorinda Çela të paraqitura në ankim, e cila kërkoi përfundimisht prishjen si të pavlefshëm të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 464, datë 28.10.2021 dhe konfirmimin e saj në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Klorinda Çela, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ajo iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), brenda afatit ligjor¹, në përputhje me nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklaratën e pasurisë².
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) *Deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin.*
 - (ii) *Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
 - (iii) *Ka kryer fshehje të pasurisë.*
 - (iv) *Ka kryer deklaram të rremë.*
 - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja,

¹ Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

² Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 23.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 23.01.2017. Të njëjtën datë mban dhe deklaratat e pasurisë vetting në rubrikën përkatëse.

DSIK-ja dhe KLGj-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Klorinda Çela, bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni, me vendimin nr. 464, datë 28.10.2021, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Klorinda Çela, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë [...]”.
6. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.
 - Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë: *Subjekti i rivlerësimit: (1) Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (2) Ka kryer fshehje të pasurisë; si dhe (3) ka kryer deklaram të rremë, duke u vendosur në kushtet e parashikuara në germat “b”, “c”, “ç”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni, bazuar në konkluzionet e mësipërme, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së saj dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
 - Në zbatim të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi Komisioni vlerësoi në tërësi të gjitha konstatimet që lidhen me vlerësimin e pasurisë, arrin në përfundimin se ato janë të tilla që e çojnë këtë trup gjykues në konkluzionin se subjekti me veprimtarinë e saj ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në një mënyrë të pariparueshme nëpërmjet programeve të trajtimit të Shkollës së Magjistraturës.
 - Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Klorinda Çela nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe nuk është treguar bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të hetimit administrativ të kryer ndaj saj.

III. Shkaqet e ankimit

7. Subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Kolegjit të Posacëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 464, datë 28.10.2021, duke e kundërshtuar atë në drejtim të procedurës së ndjekur nga ana e Komisionit si dhe vlerësimit të kryer nga ky i fundit, kryesisht për kriterin e pasurisë.
8. Subjekti i rivlerësimit, znj. Klorinda Çela, pretendoi se hetimi dhe vlerësimi administrativ kanë qenë të cekët dhe analiza financiare pa logjikë ekonomike. Sipas saj, ky vendim është i pavlefshëm dhe rrjedhimisht kërkon kryerjen e një hetimi të plotë, si dhe rivlerësimin e subjektit edhe për dy kriteret e tjera të vlerësimit. Subjekti pretendoi gjithashtu se vendimi objekt ankimi është i paligjshëm, pasi vjen në kundërshtim me nenet D, E, Ë të Aneksit të Kushtetutës, si dhe me nenet

4, 33, 61 etj. të ligjit nr. 84/2016. Komisioni, sipas subjektit, ka aplikuar masën disiplinore “shkarkim nga detyra” në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin.

9. Subjekti i rivlerësimit, znj. Klorinda Çela, kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale të procesit të zhvilluar në Komision dhe vlerësimin e kriterit të pasurisë, dhe në përfundim të gjykimit, të vendosë:
- *Prishjen e vendimit nr. 464 datë 28.10.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*
 - *Pavlefshmërinë e vendimit nr. 464, datë 28.10.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*
 - *Konstatimin e pavlefshmërisë së procedurës së hetimit administrativ, seancës dëgjimore, vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare të trupit gjykues.*
 - *Përsëritjen e hetimit gjyqësor, brenda shkaqeve të ankimit. Marrjen e provave të kërkuara prej subjektit të rivlerësimit, duke e gjykuar çështjen në seancë gjyqësore publike, kryerjen e hetimit dhe për dy kriteret e tjera.*
 - *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Klorinda Çela, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. *Mbi aspektet procedurale të gjykimit*

a) *Juridiksioni i Kolegjit*

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, që ka vendosur për rivlerësimin kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Klorinda Çela, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) *Legjitimimi i ankuesit*

11. Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh³ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

³ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 464, datë 28.10.2021, për rivlerësimin e subjektit, znj. Klorinda Çela, i është njoftuar kësaj të fundit me shkresën nr. {***} prot., datë 22.01.2021, konfirmuar marrja dijeni nga z. K. Dh. (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), më datë 25.11.2021, sipas

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

12. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar”, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 464, datë 28.10.2021, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, fillimisht u mor në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
13. Trupi gjykues, pasi kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni

14. *Subjekti i rivlerësimit, znj. Klorinda Çela, kundërshtoi si të pavlefshëm vendimin objekt ankimi me pretendimin se vendimi është marrë nga një trup gjykues që:*

14.1. *Nuk përmbush kriterin e të qenit një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, bazuar në nenin 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, znj. Klorinda Çela pretendoi⁴ se: (i) Dy nga anëtarët e trupit gjykues që kanë shqyrtuar çështjen e rivlerësimit të saj (L. H. dhe E. Ç.) nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në ligj për t'u përzgjedhur si komisionerë. Më konkretisht, sipas subjektit të rivlerësimit, këta dy komisionerë nuk plotësojnë në mënyrë kumulative dy kushtet e përcaktuara për të qenë “anëtar i Gjykatës së Lartë nga jashtë sistemit” (gradë shkencore dhe jurist i spikatur), përcaktuar në nenin 136/3 të Kushtetutës. Përpos sa më sipër, sipas subjektit, këta dy komisionerë nuk plotësojnë as kriterin e parashikuar në paragrafin e pestë të nenit C të Aneksit të Kushtetutës, pasi për ta nuk provohet eksperiencia 15 vjeçare sipas përcaktimit të kësaj dispozite. Subjekti referoi gjithashtu mungesë të plotësisimit të këtij kriteri edhe për komisioneren B. B.⁵ (ii) Analiza financiare e cila ka qenë thelbësore në marrjen e vendimit objekt ankimi, është kryer nga këshilltari ekonomik, një nëpunës*

*lajmërimarrjes së shërbimit postar. Kurse ankimi i subjektit rezulton të jetë depozituar në Komision në datë 09.12.2021, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit nr. {***}, datë 09.12.2021, që rezulton të jetë dita e 14-të nga data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit. Për rrjedhojë, subjekti e ka dorëzuar ankimin në Komision brenda afatit ligjor për të ushtruar ankim në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.*

⁴ *Subjekti referoi vendimin e GjEDNj-së në çështjen Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës.*

⁵ *Ky pretendim duket te jetë ndonjë lapsus për sa kohë kjo Komisionere nuk ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar çështjen e saj.*

i Komisionit, i punësuar prej këtij të fundit dhe që ka varësi ekonomike dhe funksionale prej tij, duke bërë të pamundur që ai të vlerësohet si ekspert i pavarur. Subjekti pretendoi se mosvënia në dispozicion e analizës financiare të Komisionit, por vetëm e një tabele përmbledhëse në të cilën nuk pasqyrohet analiza e veprimeve të kryera që kanë çuar në rezultatin financiar, ka cenuar pavarësinë e trupit gjykues.

14.2. *Trupi gjykues ka qenë i njëanshëm, diskriminues, në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës dhe nenin 17 të Kodit të Procedurave Administrative*⁶. Në mbështetje të këtij shkak subjekti i rivlerësimit, znj. Klorinda Çela pretendoi se trupi gjykues që ka gjykuar çështjen e saj përveçse ka qenë i caktuar në kundërshtim me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në Aneksin e Kushtetutës dhe në ligjin 84/2016, ka cenuar edhe të drejtën e subjektit për t'u dëgjuar dhe aksesin e saj në gjykatë, në shkelje të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së, si dhe pa një shkak ligjor. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit, kërkoi konstatimin e shkeljeve të rënda procedurale dhe prishjen e vendimit të Komisionit.

15. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues vlerësoi fillimisht se pretendimet për cenim të parimeve të procesit të rregullt, të adresuara nga subjekti i rivlerësimit në drejtim të mosplotësimit nga dy prej anëtarëve të trupit gjykues, të kriterëve për të qenë komisionerë, duke iu referuar mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara në nenin 136, pika 3 e Kushtetutës, që lidhen me zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës së Lartë, janë të pabazuara. Kriteret për t'u zgjedhur komisioner i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë përcaktuar shprehimisht në nenin C, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 6 të ligjit nr. 84/2016, dhe se, referuar jurisprudencës së Kolegjit në çështje të mëparshme⁷, pretendimet e ngritura nga subjektet e rivlerësimit lidhur me mospërmbushjen e kriterëve ligjore për zgjedhshmërinë në detyrë të komisionerit, janë vlerësuar nga Kolegji se nuk bëjnë pjesë në kompetencën juridiksionale të këtij të fundit.
16. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se këshilltarët ekonomikë të Njësisë së Shërbimit Ligjor të Komisionit nuk janë ekspertë të pavarur dhe se varësia e tyre ekonomike dhe funksionale, si të punësuar të Komisionit ka cenuar pavarësinë dhe paanësinë e këtij të fundit në rivlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas analizës ekonomike të përgatitur nga këshilltari ekonomik, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim është i pabazuar si në ligj, ashtu edhe në praktikën tashmë të konsoliduar të Kolegjit.
17. Referuar parashikimeve të nenit 23, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, detyra kryesore e këshilltarëve ekonomikë të Njësisë së Shërbimit Ligjor të institucioneve të rivlerësimit është përgatitja e relacionit të çështjes, veçanërisht për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet kryerjes së një analize financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën e rivlerësimit të subjekteve dhe personave të lidhur me ta. Kjo detyrë ligjore përmbushet nga këshilltarët

⁶ Referenca në nenin 17 të Kodit të Procedurave Administrative duket të jetë lapsus. Nga leximi i kësaj pjese të ankimit subjekti duket të ketë pasur për qëllim referimin në nenin 17 të Kushtetutës.

⁷ Shih vendimin e Kolegjit nr. 3(JR), datë 06.02.2023.

ekonomikë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, si dhe në referim të standardeve të vendosura nga Kolegji në drejtim të çështjeve që lidhen me mënyrën e vlerësimit të pasurive të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta. Këto parashikime të ligjit nr. 84/2016 kanë kaluar edhe kontrollin e kushtetutshmërisë të vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 2, datë 18.01.2017, sipas së cilit nuk është konstatuar që mënyra e organizimit dhe funksionimit të Njesisë së Shërbimit Ligjor, të cenojë paanësinë e Komisionit në shqyrtimin e çështjeve të rivlerësimit.

18. Trupi gjykues vlerësoi si të pabazuar në fakte edhe pretendimin se mos vënia në dispozicion të subjektit të rivlerësimit e analizës financiare të Komisionit, por vetëm e një tablele përmbledhëse në të cilën nuk pasqyrohet analiza e veprimeve të kryera që kanë çuar në rezultatin financiar, ka cenuar pavarësinë e trupit gjykues. Nga verifikimi i akteve të fashikullit të çështjes, trupi gjykues konstatoi se referuar përmbajtjes së rubrikës “Analiza financiare për vitet 2003-2016” të relacionit të rezultateve të hetimit të përgatitur nga Komisioni, rezultoi se tabela e analizës financiare “Aneks-1”, bashkëlidhur rezultateve të hetimit, ishte shoqëruar edhe me metodologjinë e ndjekur nga Komisioni për kryerjen e kësaj analize. Për më tepër, nga analizimi i komunikimit të Komisionit me *e-mail*-in e datës 06.10.2021, me anë të të cilit subjektit të rivlerësimit i janë përcjellë rezultatet e hetimeve, trupi gjykues vërejtë se përveç tabelës përmbledhëse të analizës financiare e cila ishte bërë pjesë e dokumentit të rezultateve të hetimit, subjektit i ishte përcjellë në rrugë elektronike në formatin *excel* edhe dokumenti “Analiza financiare Klorinda Çela 24.9.2021”. Analiza financiare e përcjellë së bashku me relacionin mbi rezultatet e hetimit administrativ, është një akt i cili mbështet rezultatet e hetimit të kryer nga Komisioni dhe që i jepet subjektit të rivlerësimit për të shprehur qëndrimin e tij lidhur me të. Në këtë kuptim, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj, nuk rezultoi që të ketë parashtruar që analiza e Komisionit ishte e pakuptueshme në drejtim të mënyrës se si ishte arritur në rezultatet përkatëse. Për rrjedhojë të sa më sipër, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit u gjet tërësisht i pabazuar në fakte.
19. Sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit, znj. Klorinda Çela, se asaj i është cenuar e drejta për t’u dëgjuar dhe për akses në gjykatë, në shkelje të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së, pa një shkak ligjor, fillimisht trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë shpjegim në mbështetje të këtij pretendimi, në kuadër të evidentimit të situatës faktike, e cila, sipas saj, i ka cenuar të drejtat procedurale. Përveç sa më sipër, trupi gjykues, pasi verifikoi procedurat e ndjekura nga Komisioni në lidhje me zhvillimin e hetimit administrativ për rivlerësimin kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Klorinda Çela, vlerësoi se ky shkak ankimi është i pabazuar në fakte dhe se e drejta për t’u dëgjuar, nëpërmjet dhënies së shpjegimeve përmes pyetësorëve të ndryshëm, prapësimeve ndaj rezultateve të hetimit dhe kalimit të barrës së provës, është garantuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Edhe e drejta për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore, në përputhje me parashikimet e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, është garantuar nga ana e Komisionit, e drejtë kjo e cila nuk duket të jetë shfrytëzuar nga ana e subjektit të

rivlerësimit, sa kohë ajo nuk është paraqitur me pretendimin e problemeve shëndetësore, por pa i provuar ato me dokumentacion justifikues.

20. Subjekti i rivlerësimit pretendoi cenim të së drejtës për mbrojtje efektive si pasojë e shkeljes nga ana e Komisionit të parimeve të parashikuara në nenin 6/3/d të KEDNj-së, duke mos i dhënë asaj të drejtën e kundërshtimit të provave të krijuara nga vetë Komisioni, mosnjohjen me ekspertët që kanë kryer vlerësimet ekonomike dhe pamundësisë për të verifikuar kushtet e mospasjes së konfliktit të interesit nga ana e tyre.
21. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues, referuar parashikimit të dispozitës së sipërcituar të KEDNj-së, të pretenduar si të cenuar, e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, për sa kohë garancitë minimale të përcaktuara nga neni 6, paragrafi 3 i KEDNj-së i referohen personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale dhe rrjedhimisht, proceseve me natyrë penale, ndërkohë që procesi i rivlerësimit kalimtar ka karakter administrativ. Garancitë e subjekteve të rivlerësimit në procedurën e kryer para Komisionit vlerësohen sipas përcaktimeve të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së. Në këto kushte, edhe ky shkak i ankimit u gjet nga trupi gjykues i pabazuar në ligj.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

22. Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të gabuar të konkluzionit të Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 114,6 m², porositur në vitin 2005 në vlerën 74.400 euro, me vendndodhje në rrugën “{***}”, Tiranë, trupi gjykues, pasi analizoi shkakun e ankimit, konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
23. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramentit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se *rezultatet e kristalizuara në fund të hetimit administrativ, lidhur me këtë pasuri, dhe të njoftuara subjektit, nuk pësojnë ndryshime nga prapësimet e subjektit dhe konfirmohet pamjaftueshmëria financiare [...]*. Komisioni ka arritur në këtë konkluzion pasi ka arsyetuar se lidhur me: (i) likuiditetet e depozituara në Tirana Bank gjatë vitit 2004, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej 810.725 lekësh për të krijuar këto likuiditete; (ii) huanë e marrë nga shtetasi A. Ç., Komisioni është shprehur se, si gjatë hetimit administrativ, por edhe pas kalimit të barrës së provës, me dërgimin e rezultateve të hetimit, por edhe nga analiza e rrethanave dhe fakteve të konstatuara prej tij në vendim, subjekti i rivlerësimit, përpos shpjegimeve të përgjithshme mbi statusin apo të kaluarën e huadhënësit të pretenduar, nuk ka depozituar asnjë dokumentacion ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasit A. Ç.. Për rrjedhojë, Komisioni, lidhur me këtë burim të krijimit të apartamentit, ka arritur në përfundimin se *personi tjetër i lidhur nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për të mundësuar dhënien e huasë në masën 2.000.000 lekë në favor të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit; (iii) të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga botimi i librit “Fjalori i termave të së drejtës, italisht - shqip - italisht”, Komisioni*

ka arsyetuar në vendim se: *edhe pas kalimit të barrës së provës subjektivit të rivlerësimit për të dhënë argumente/shpjegime dhe/apo prova që të provonin të kundërtën e rezultateve të arritura nga Komisioni në prapësimet e depozituara, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim duke rikonfirmuar se mosparaqitja e dokumentit justifikues është tërësisht e justifikuar, pasi edhe sot shitja e librave nga autorët bëhet joformalisht dhe se shitësit e librave në atë kohë nuk nxirrnin kupon tatimor.* Në këto kushte, Komisioni ka çmuar se lidhur me këto të ardhura nuk gjen arsye për të ndryshuar vlerësimin e tij sipas rezultateve të hetimit të kryer në këtë drejtim, duke arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të mundësuar plotësisht pagesën e këstit të parë për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

24. Subjekti i rivlerësimit, znj. Klorinda Çela, në ankimin e saj ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë pasuri, duke ngritur pretendimet e mëposhtme.

24.1. Konkluzioni i Komisionit për deklarim të pasaktë të kësaj pasurie në lidhje me vlerën e çmimit të blerjes është i gabuar dhe se në këtë rast bëhet fjalë për një lapsus në deklarim. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se, në deklaratimet periodike vjetore para ILDKPKI-së, ashtu edhe bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, ka dorëzuar kontratën e shitjes me rezervë pronësie, si dhe kontratën e kredisë dhe kontratat e kolateralit të vendosura nga ana e shoqërisë ndërtuese, në të cilat është përcaktuar saktë çmimi i blerjes së apartamentit prej 74.400 eurosh.

24.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar edhe konkluzionet e Komisionit për mosdeklarim në DIPPV-në e vitit 2005 të pagesës së këstit të parë të çmimit të apartamentit, në vlerën e 22.400 eurove, dhe për mospërputhje mes DIPPV-së së vitit 2005 dhe deklaratës së pasurisë *vetting*, sa i takon burimeve të krijimit të pasurisë objekt kontrolli. Subjekti pretendoi se, edhe sikur të kishte deklarim të pasaktë në deklaratën periodike të vitit 2005 dhe atë të pasurisë *vetting*, kjo, sipas saj, nuk nënkupton fshehje apo “deklarim pasurie”⁸, duke qenë se subjekt i deklaramit të pasurive, përveç saj, ka qenë edhe bashkëshorti i saj K. Dh..

24.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar rezultatin e analizës financiare dhe konkluzionin e Komisionit për pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme lidhur me krijimin e depozitave bankare në vitin 2004, si dhe qëndrimin e tij në vendim se si burim për krijimin e llogarive bankare në vitin 2004 mund të kenë shërbyer vetëm të ardhurat e krijuara gjatë këtij viti (2004). Në mbështetje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendoi se në atë periudhë bashkëshorti i saj ka qenë student i shkollës së Magjistraturës, që prej vitit 2001 dhe, po ashtu edhe vetë subjekti ka qenë studente pranë së njëjtës shkollë që prej vitit 2003 dhe, rrjedhimisht, të ardhurat e tyre nuk mund të kenë qenë vetëm ato të krijuara gjatë vitit 2004. Sipas subjektivit të rivlerësimit, analiza e kryer nga Komisioni lidhur me këto depozitime duhet të kishte mbajtur në konsideratë edhe gjendjen e viteve paraardhëse 2003 dhe 2001-2002.

⁸ *Duket si lapsus, mbase subjekti ka dashur të thotë “mosdeklarim” pasurie.*

24.4. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit lidhur me marrëdhënien e huasë, në shumën e 2.000.000 lekëve, mes bashkëshortit të saj dhe z. A. Ç., dhe pretendoi se marrëdhënia financiare mes këtij të fundit dhe bashkëshortit të subjektit bazohet në një marrëdhënie ndihme të ndërsjellë dhe jo në një logjikë fitimi. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo marrëdhënie huaje nuk mund të shihet e shkëputur nga marrëdhënia e ngushtë e miqësisë që ka ekzistuar mes bashkëshortit të saj dhe z. Ç.. Në kundërshtim të konkluzionit të Komisionit mbi pamundësinë e dhënies së kësaj huaje nga z. Ç., subjekti i rivlerësimit, znj. Klorinda Çela, pretendoi se konkluzioni i Komisionit lidhur me këtë aspekt është një hamendësim dhe nuk ka lidhje me sa ka ndodhur në realitet. Sipas saj, kjo marrëdhënie bazohet në akte të mbajtura para noterit dhe, si të tilla, ato provohen me prova shkrësore.

24.5. Sa u takon të ardhurave në shumën përafërsisht 300.000 lekë, të deklaruara nga bashkëshorti si të realizuara nga shitja e librit “Fjalori i termave [...]”, subjekti i rivlerësimit pranoi faktin e mosdorëzimit prej saj të dokumentacionit justifikues lidhur me këto të ardhura dhe pretendoi se, edhe sot, shitja e librave nga ana e autorëve bëhet joformalisht.

25. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të parashtruara në ankim, vlerësuar këto në raport me aktet e administruara në fashikullin gjyqësor të çështjes dhe arsytimin e Komisionit në vendim, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
26. Trupi gjykues fillimisht konstatoi se konkluzioni përfundimtar i Komisionit lidhur me këtë pasuri është artikuluar vetëm në drejtim të pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e saj. Pavarësisht evidentimit në rezultatet e hetimit mbi deklarimin e pasaktë lidhur me vlerën/çmimin e blerjes së kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting* (ku çmimi i blerjes është deklaruar 74.000 euro nga 74.400 euro që është përcaktuar në kontratën e shitjes me rezervë, nr. {***} prot., datë 03.06.2005, të lidhur mes subjektit të rivlerësimit, bashkëshortit të saj dhe shoqërisë “{***}” ShPK, vërtetuar nënshkrimet e palëve sipas vërtetimit të noterit publik R. S., nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.06.2005), në vendimin e dhënë, Komisioni duket se ka konfirmuar rezultatet e hetimit vetëm në drejtim të mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie⁹. Në këtë kontekst, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk paraqet relevancë në drejtim të kundërshtimit të konkluzionit të Komisionit lidhur me këtë pasuri edhe pse, pas verifikimit të akteve të fashikullit, trupi gjykues konstatoi se deklarimi i vlerës së kësaj pasurie, si pretenduar dhe nga subjekti i rivlerësimit, kuptohet të jetë një lapsus në deklarim, në konsideratë edhe të faktit që ky deklarim është shoqëruar nga subjekti i rivlerësimit me të gjitha aktet e origjinës së krijimit të kësaj pasurie, ku konfirmohet edhe çmimi i blerjes së saj prej 74.400 eurosh.
27. Trupi gjykues arriti në të njëjtin konkluzion se pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në kundërshtimin e konstatimeve të Komisionit lidhur me mosdeklarimin në DIPPV-në e vitit 2005 të pagesës së shumës prej 2.770.000 lekësh, që përbënte këstin e parë të çmimit të apartamentit

⁹ Shih paragrafin 57 të vendimit të Komisionit.

dhe të burimit të tij, si dhe mbi mospërputhjet e konstatuara në deklarin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie në DIPPV-në e vitit 2005, krahasuar me ato të deklaruara në deklaratën *vetting*, nuk kanë relevancë në shqyrtimin e këtij shkaku ankimi dhe, rrjedhimisht, në cenimin e konkluzionit të Komisionit lidhur me pasurinë objekt kontrolli, për sa kohë rezultoi që Komisioni të mos kishte arritur në ndonjë konkluzion, sipas të cilit t'i atribuonte subjektit të rivlerësimit pasojat juridike të deklarimit të pasaktë.

28. Sa i takon shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në kundërshtim të konkluzionit të Komisionit lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme, për kryerjen e pagesës së kështit të parë të apartamentit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, vëren si më poshtë.

28.1. Me kontratën e shitjes me rezervë, të lidhur më datë 03.06.2005, mes shoqërisë “{***}” SHPK, në cilësinë e shitësit dhe subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, në cilësinë e blerësit, vërtetuar sipas vërtetimit të noterit publik R. S., nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.06.2005, rezulton se subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj i është premtuar shitja e apartamentit “Tip 5”, me sipërfaqe ndërtimi 114,6 m² dhe sipërfaqe të përbashkëta 9,4 m², me vendndodhje në katin e shtatë të një objekti në ndërtim, në rrugën “{***}”. Sipas parashikimit të kësaj kontrate, *çmimi i shitjes së apartamentit është 74.400 euro, i cili do të paguhet me këste. Kësti i parë, në vlerën prej 22.400 eurosh, do të paguhet me nënshkrimin e kësaj kontrate, ndërsa kësti i dytë prej 52.000 eurosh për t’u paguar me kredi bankare brenda datës 30.07.2005.*

28.2. Bashkëlidhur kësaj kontrate ndodhen edhe konfirmimet e dy transfertave bankare lidhur me pagesat e kryera për blerjen e pasurisë objekt kontrolli, sipas përcaktimit të sipërcituar në kontratën e shitjes me rezerve të pasurisë. Konkretisht: (i) transferta e parë e kryer nga subjekti i rivlerësimit në datën e lidhjes së kontratës, më 03.06.2005, në shumën 2.770.000 lekë, me përshkrimin “*Trf¹⁰ te {***} SHPK, Lik. 30% Blerje Shtëpie (22.400 EUR)*”; dhe (ii) transferta e dytë, në vlerën e 52.000 eurove, e kryer nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit K. Dh., më datë 31.08.2005, me përshkrimin “*Likuidim apartamenti*”.

28.3. Me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.04.2015, të lidhur para noteres M. D., shoqëria “{***}” SHPK, në cilësinë e shitësit, u ka shitur subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, të përfaqësuar në këtë kontratë nga z. A. Ç., pasurinë e paluajtshme, apartament me nr. pasurie {***}, Vol {***}, Fq {***}, me sipërfaqe 114,6 m², Hyrja {***}, Ap. {***}, me adresë në rrugën “{***}”, [...] *përkundrejt një çmimi total prej 74.400 eurosh (shtatëdhjetë e katër mijë), e konvertuar në shumën prej 9.195.840 lekësh, me kursin 123,6. Referuar nenit 5 të kësaj kontrate: Shitësi deklaron se blerësi ka paguar paraprakisht të gjithë çmimin e shitjes së pasurisë së paluajtshme “apartament” objekt kontrate, në shumën prej 74.400 eurosh, sipas kontratës së shitjes me rezervë, me nr. prot. {***}, datë 03.06.2005, vërtetuar nëpërmjet vërtetimit noterial me nr. rep. {***} dhe nr. kol. {***}, datë 08.06.2005, e noteres R. S., bashkëlidhur kësaj kontrate, shumë e përfutur totalisht nga shitësi.*

¹⁰ Akronim për “transferim”.

28.4. Nga hetimi i kryer nga Komisioni është konstatuar se, nga shqyrtimi i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, sipas dokumentacionit bankar të administruar¹¹, ka rezultuar se shuma prej 2.770.000 lekësh është krijuar nga:

- a) depozitimet e shumave prej 410.000 lekësh¹² dhe 350.000 lekësh nga subjekti i rivlerësimit, në llogarinë personale në Tirana Bank, në datat 16.3.2004 dhe 15.7.2004;
- b) depozitim i shumës 719.800 lekë nga subjekti i rivlerësimit, në llogarinë personale në të njëjtën bankë, në datën 12.5.2005;
- c) transferim i shumës 668.856 lekë nga bashkëshorti i subjektit, në llogarinë e subjektit në Tirana Bank, në datën 3.6.2005;
- d) depozitim i shumës 1.050.000 lekë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në llogarinë e përbashkët në Tirana Bank, në datën 3.6.2005.

28.5. Nga shqyrtimi i deklaratave periodike të dorëzuara para ILDKPKI-së, të administruara gjatë hetimit administrativ, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin e saj të parë në vitin 2005, i cili i korrespondon deklaratës periodike të vitit 2004. Ndonëse ajo rezulton të ketë filluar punë në shtator të vitit 2004, deklarata e saj para fillimit të punës, sipas parashikimeve të nenit 9 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 9049/2003), nuk duket të jetë administruar në dosjen e hetimit të Komisionit. Trupi gjykues vëren se bashkëshorti i saj, z. K. Dh. (subjekt deklarues edhe për shkak të detyrës së tij si gjyqtar), rezultoi të ketë dorëzuar deklaratën e tij të parë në datën 31.03.2004. Referuar kësaj deklarate, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, i cili në cilësinë e tij si subjekt deklarues para ILDKPKI-së, në kuadër të parashikimeve të ish-nenit 6, në kombinim me nenet 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049/2003, ka pasur detyrimin për të deklaruar të gjitha pasuritë e akumuluar të tij dhe të familjes së tij, deri në datën e dorëzimit të kësaj deklarate pranë ILDKPKI-së, rezulton që në Formularin A – 5 “Likuiditete” të mos ketë deklaruar as likuiditete në gjendje *cash*, as likuiditete në sistemin bankar në formën e depozitave bankare apo gjendjeve në llogari rrjedhëse.

28.6. Në kushtet kur, gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, ka rezultuar se në datën e dorëzimit të deklaratës për herë të parë, më 31.03.2004, ndonëse e padeklaruar në këtë deklaratë, ekzistonte një depozitë bankare në emër të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se kjo depozitë duhet të verifikohej lidhur me burimet e krijimit të saj, duke marrë në konsideratë çdo burim të ligjshëm të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, para datës së krijimit të depozitës. Në këtë kuptim, sa i takon analizës financiare të kryer nga Komisioni lidhur me këtë depozitë, gjendet i drejtë dhe i bazuar në fakte dhe në ligj pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka gabuar në mosmarrjen në konsideratë të të ardhurave të pagave të saj

¹¹ Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga Tirana Bank nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 12.03.2020, protokolluar në KPK me nr. {***} prot., datë 5.5.2020.

¹² Shuma të cilat janë shtuar me të ardhurat nga interesat dhe gjendja në fund të vitit 2004, ka qenë 845,975 Lekë. Nga kjo shumë është tërhequr në datë 21.1.2005, shuma prej 489,820 Lekë.

dhe të bashkëshortit të saj në periudhat e mëparshme. Sa i takon vlerësimin të dy depozitave të tjera të krijuara në datat 15.07.2004 dhe 30.08.2004, referuar parashikimeve ligjore të ish-nenit 6 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, sipas të cilave, nëse subjektet deklaruese kishin pasuri në formën e gjendjes *cash* në banesë, të akumuluar nga kursimet e të ardhurave të tyre ndër vite, duhet ta kishin deklaruar atë, si dhe të faktit se ekzistenca e këtyre kursimeve nuk u provua në asnjë formë të mundshme para krijimit të këtyre depozitave, trupi gjykues vlerësoi se analiza e këtyre dy depozitave duhet të kryhet mbi bazën e të ardhurave dhe shpenzimeve, për periudhën kohore nga data e deklarimit të parë të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, më 31.03.2004 – deri në datat e depozitimeve të kryera.

28.7. Nga kontrolli i analizës së kryer nga Komisioni mbi bazën e konkluzioneve të mësipërme, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të justifikuar shumën e depozituar prej 410.000 lekësh, në datën 16.3.2004, ndërsa lidhur me dy depozitimet e kryera në vijim, në datat 15.7.2004 dhe 30.8.2004, përkatësisht në shumat 350.000 lekë dhe 650.000 lekë, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme, në shumën e (-)717.817 lekëve.

28.8. Sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në lidhje me huanë e marrë nga z. A. Ç., në shumën prej 2.000.000 lekësh, dhe të deklaruar për herë të parë në datën 27.03.2006 nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në deklarimin e tij periodik për vitin 2005, të deklaruar në vijim edhe nga subjekti i rivlerësimit në datën 07.02.2008, në formën e një plotësimi/korrigjimi të deklarimit të deklaratës periodike të vitit 2006, në vijim të sqarimeve të dhëna në ILDKPKI në këtë datë, trupi gjykues vëren fillimisht se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në ankim të njëjtat pretendime me ato të paraqitura në Komision, në kuadër të kundërshtimit të rezultateve të hetimit, pretendime këto të cilat rezultojnë të jenë analizuar në vendimin e Komisionit. Megjithatë, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes lidhur me këtë marrëdhënie të deklaruar huaje mes bashkëshortit të subjektit K. Dh. dhe z. A. Ç., i gjeti të bazuara në prova konstatimet e Komisionit se huaja objekt kontrolli nuk mund të ketë shërbyer si burim për kryerjen e pagesës së kësaj të parë prej 2.770.000 lekësh, për sa kohë kjo pagesë është kryer në datën 03.06.2005, ndërkohë që kontrata e huadhënies është lidhur në datën 22.07.2005, me datë fillimi 20.06.2005, si deklaruar edhe nga vetë huamarrësi (K. Dh.) në DIPPV-në e vitit 2005.

28.9. Në arritjen e konkluzionit të mësipërm, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe konstatimin se, nga shqyrtimi i deklaratës periodike të vitit 2005, të dorëzuar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me huanë e marrë nga shtetasi A. Ç., nuk ishte deklaruar qëllimi/arsyeja e marrjes së kësaj huaje, si pretenduar nga subjekti i rivlerësimit për pagesën e çmimit të apartamentit, ndryshe nga sa deklaruar nga bashkëshorti në të njëjtën njëjtin formular, një rubrikë më poshtë, lidhur me huanë e marrë pranë Bankës Tirana, me qëllim “për blerje apartamenti”. Ky konkluzion i trupit gjykues përforcohet edhe nga fakti që në përgjigjet e pyetësorit të parë të drejtuar subjektit nga Komisioni, kjo e fundit, në sqarimet e dhëna lidhur me qëllimin e marrjes së kësaj huaje, ka deklaruar: *Qëllimi i huasë nuk është specifikuar në kontratën e huasë, por që është marrë me qëllim mbulimin e shpenzimeve të ndryshme tonat (me sa mbaj mend edhe për shlyerje*

të ndonjë pjese kredie që kishim marrë). Në lidhje me burimin e të ardhurave të këtij shtetasi, mund të bëni verifikimet përkatëse për këtë periudhë të mundësisë së tij për të dhënë këtë hua. Nuk mundem dhe nuk ka sesi t'i kërkoj llogari për burimet e tij. Nga ana juaj, të bëhen verifikimet përkatëse, pasi ai ka bërë dhe deklarime në Prokurori¹³, ndërsa në prapësimet e saj ndaj rezultateve të hetimit lidhur me gjetjen e Komisionit se kjo hua nuk mund të kishte shërbyer si burim për kryerjen e pagesës së këstit të parë, subjekti i rivlerësimit është shprehur: *Konkluzioni juaj se kjo hua nuk mund të ketë shërbyer si burim krijimi për pagimin e këstit është një hamendësim që nuk ka aspak lidhje me atë që ka ndodhur në të vërtetë*. Për sa më lart, trupit gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të përmbysë barrën e provës në lidhje me këtë gjetje të Komisionit.

28.10. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues vëren se, ndonëse kjo gjetje e Komisionit rezultoi e bazuar në fakte, Komisioni, konkluzionin përfundimtar të tij lidhur me vlerësimin e kësaj huaje në kuadër të vlerësimit të burimeve për kryerjen e pagesës së këstit të parë, e ka lidhur me pamundësinë për të provuar burimet e ligjshme të huadhënësit. Nga verifikimi i kryer në aktet e administruara në fashikullin e çështjes¹⁴, trupi gjykues konstatoi se, pavarësisht hetimit të kryer kryesisht nga ana e Komisionit, ndodhur para faktit se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë dokumentacion justifikues në mbështetje të pretendimit se shuma e dhënë hua është krijuar nga puna e huadhënësit në emigracion dhe nga angazhime të ndryshme të tij në sektorin privat, nuk u arrit të provohet ligjshmëria e kësaj huadhënieje, në kuptim të kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe, rrjedhimisht, mosnjohja e shumës së huasë si e hyrë në ekonominë familjare të subjektit të rivlerësimit për vitin 2005 u gjet e drejtë dhe e bazuar.

28.11. Në lidhje me të ardhurat në shumën “përafërsisht 300.000 lekë”, të deklaruara si të realizuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nga shitja e librit “fjalori i termave [...]”, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, si dhe konstatoi se, lidhur me deklarinimin e këtyre të ardhurave, nuk ka asnjë dokumentacion provues në drejtim të vlerës së kësaj të ardhure, datës së realizimit të tyre, si dhe mënyrës së përfitimit, apo dhe faktit të përmbushjes apo përjashtimit nga detyrimet përkatëse që burojnë sipas legjislacionit të zbatueshëm lidhur me tatimin mbi të ardhurat personale, trupi gjykues arriti në të njëjtin konkluzion si Komisioni për mospërfshirjen e këtyre të ardhurave si burim për pagesën e këstit të parë të apartamentit, për sa kohë nuk u arrit të provohet as vlera e këtyre të ardhurave dhe as përmbushja e standardeve të përcaktuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës, lidhur me kuptimin e të ardhurës së ligjshme.

28.12. Në vijim të sa më sipër, në kushtet kur depozitimet e kryera në datat 15.07.2004 dhe 30.08.2004 rezultojnë të jenë mbartur si gjendje deri në datën e pagesës së këstit të parë të apartamentit, në datën 03.06.2005, dhe të jenë përdorur për shlyerjen e tij, trupi gjykues gjen të drejtë dhe të bazuar konkluzionin se kjo mungesë burimesh të ligjshme financiare lidhur me

¹³ Për më tepër shih përgjigjen e pyetjes nr. 19 të pyetësorit standard.

¹⁴ Dokumentacionit dhe informacionit të marrë nga organi kompetent tatimor¹⁴ dhe faktit që subjekti i rivlerësimit nuk dorëzoi asnjë dokumentacion justifikues lidhur me burimet e të ardhurave të huadhënësit, përveç deklarinimit të këtij të fundit në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} datë 29.10.2016 se kjo shumë është përfituar prej punës disaveçare të bërë prej meje në shtetin grek.

depozitimet bankare të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj gjatë vitit 2004 transferohet në po të njëjtën vlerë edhe në shlyerjen e këstit të parë. Ndonëse trupi gjykues vëren se Komisioni nuk ka kryer një analizë financiare të posaçme lidhur me momentin e pagesës së këstit të parë të apartamentit dhe vlerësimin e mungesës totale së burimeve të ligjshme për shlyerjen e tij, në kushtet kur depozitat e vitit 2004, të cilat kanë shërbyer si burim për shlyerjen e këtij kësti, rezultuan me mungesë të burimeve të ligjshme, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të rezultuan me mungesë të burimeve të ligjshme për shlyerjen e këstit të parë, më së paku në shumën e (-) 717.817 lekëve.

29. Në përfundim, trupi gjykues arriti në të njëjtin konkluzion si Komisioni se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk arritën të përmbushin detyrimin kushtetues të parashikuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës, për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara, duke rezultuar edhe pas kontrollit të ushtruar në Kolegj në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për krijimin e pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 114,6 m², me vendndodhje në rrugën “{***}”, Tiranë, porositur në vitin 2005, në shumën 74.400 euro.
30. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “ambient shërbimi, dyqan” me sip. 44 m², me vendndodhje në rr. “{***}”, Tiranë, trupi gjykues, pasi analizoi shkakun e ankimit, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
31. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramentit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se: *subjekti i rivlerësimit, znj. Klorinda Çela, nuk arriti të provonte me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të personit tjetër të lidhur, në mënyrë që ky i fundit të mundësonte blerjen e pasurisë së llojit “njësi shërbimi”, e cila më pas i është dhuruar subjektit dhe bashkëshortit të saj, në vitin 2012. Këtë konkluzion, Komisioni e arriti bazuar në arsyetimin se, megjithëse i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit në mënyrë të përsëritur, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe pas dërgimit të rezultateve dhe kalimit të barrës së provës dokumentacionin ligjor justifikues lidhur me mënyrën e përfitimit të pronësisë së pasurisë objekt kontrolli dhe burimin e ligjshëm të krijimit të saj nga personi tjetër i lidhur, dhuruesi/prindërit e subjektit të rivlerësimit, kjo e fundit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ligjor që të provonte konkretisht burimet e ligjshme të përdorura. Sipas Komisionit, subjekti, në asnjë rast, nuk deklaroi vlerën e blerjes së pasurisë nga pala dhuruese, duke mbajtur qëndrim jobashkëpunues dhe duke u shprehur se këto prova i ka depozituar më parë në ILDKPKI.*
32. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar si të gabuar konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë pasuri, duke e mbështetur këtë shkak ankimi në pretendimet e mëposhtme.
 - 32.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konstatimin e Komisionit për mungesën e informacionit lidhur me regjistrimin e kësaj pasurie në emër të blerëses, znj. Sh. M., duke pretenduar se kontrata e shitjes është bërë para noterit dhe se ajo është regjistruar konform legjislacionit në fuqi.

32.2. Subjekti pretendoi se ka paraqitur pranë ILDKPKI-së, së bashku me deklaratën e pasurisë *vetting*, kontratën e blerjes nga babai i saj, si dhe atë të dhurimit prej tij subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, sikundër edhe kontratën e shitjes së kësaj pasurie në vijim. Subjekti i rivlerësimit sqaroi se kontratës së dhurimit nuk i ka vendosur vlerë me justifikimin se dhurata nuk vlerësohet, ndërkohë që rivlerësimi është kryer pas dhurimit për efekt të kredimarrjes. Sipas subjektit të rivlerësimit, e gjithë shuma e shitblerjes së pasurisë objekt kontrolli është kryer në bankë dhe nëpërmjet llogarisë së noteres.

32.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pasaktë konstatimin e Komisionit se, referuar informacionit nga UKT-ja, ekzistojnë tre kontrata në emër të bashkëshortit të saj. Sipas subjektit, në emër të bashkëshortit të saj ekziston vetëm një kontratë me UKT-në, që i përket banesës në Rr. “{***}”. Po ashtu, i pasaktë sipas subjektit është edhe informacioni i përcjellë nga FSHU-ja se në emër të saj dhe të bashkëshortit nuk rezulton të jetë lidhur kontratë e furnizimit me energji elektrike. Subjekti prapësoi se nuk mban përgjegjësi për hapje kontratash pa kërkesë të bashkëshortit apo për mosregjistrim në regjistrat *online* të FSHU-së.

32.4. Lidhur me konstatimin e Komisionit për mospërputhje në numrat e pasurisë objekt kontrolli mes regjistrimit të kësaj pasurie, fillimisht në emër të babait të subjektit dhe me vonë në emër të subjektit, kjo e fundit pretendoi se, në arritjen e këtij konkluzioni, Komisioni ngatërron shtetasin V. Dh. me babain e saj Sh. Ç..

32.5. Sa u takon burimeve të krijimit të kësaj pasurie, subjekti kundërshtoi si të padrejtë aludimin e Komisionit se, si burim për krijimin e kësaj pasurie nga prindërit e saj, kanë shërbyer të ardhurat nga shpronësimi, sipas *Njoftimit publik nr. {***} prot., datë 09.12.2014*. Sipas subjektit, ajo dhe bashkëshorti i saj asnjëherë nuk kanë deklaruar se burimi i krijimit të pasurisë së dhuruar nga i ati ka qenë shuma e shpronësimit.

32.6. Sa i takon verifikimit të burimeve të krijimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit, znj. Klorinda Çela, pranoi si të drejtë konstatimin e Komisionit se ajo nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor mbi mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie nga dhuruesit (prindërit e subjektit), duke pretenduar se sa më sipër është pasojë e ekonomisë informale. Në mbështetje të pretendimit se kjo pasuri është krijuar me burime të ligjshme, subjekti pretendoi se prindërit dhe vëllezërit e saj kanë qenë në emigracion, kanë ushtruar aktivitet privat “shitblerje me shumicë e pakicë” (duke deklaruar për këtë qëllim në deklaratën e pasurisë *vetting* edhe një pagesë takse të bashkisë për vendin e aktivitetit). Subjekti i rivlerësimit parashtrroi gjithashtu se prindërit dhe vëllezërit e saj nuk kanë qenë asnjëherë subjekte hetimesh apo gjykimesh për aktivitete të paligjshme.

32.7. Lidhur me periudhat e përdorimit të ambientit me qira nga shtetasit E. Dh. dhe A. Ç., subjekti pretendoi se ato janë pasqyruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, periudhë në të cilën janë paguar dhe tatimet përkatëse. Sipas subjektit, së bashku me deklaratën e pasurisë *vetting*, janë dorëzuar të gjithë provat shkresore të noterizuara.

33. Në shqyrtim të këtij shkakut ankimi, pasi analizoi dokumentin e rezultateve të hetimit, kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me gjetjet e hetimit për pasurinë objekt kontrolli, për të cilën Komisioni i kishte kaluar barrën e provës, si dhe konkluzionin përfundimtar të Komisionit lidhur me këtë pasuri të shprehur në vendim, trupi gjykues konstaton fillimisht se pretendimet e ngritura në ankim nga subjekti lidhur me këtë pasuri, sipas paragrafëve 32.1-32.5 dhe 32.7 të këtij vendimi, janë të njëjta me prapësimet e subjektit të rivlerësimit ndaj rezultateve të hetimit. Këto pretendime, të vlerësuara në raport me konkluzionin përfundimtar të Komisionit, çmohet se nuk paraqesin asnjë relevancë në drejtim të ngritjes së një shkakut ligjor për cenimin e konkluzionit të Komisionit lidhur me pasurinë objekt kontrolli, për sa kohë konstatimet e kundërshtuara nga subjekti janë referuar nga Komisioni në rubrikën e hetimit të kryer prej tij dhe nuk gjejnë pasqyrim në konkluzion përfundimtar, i cili lidhet me paprovueshmërinë e burimeve të ligjshme të dhuruesve për blerjen e pasurisë së dhuruar subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj. Në këtë kuptim, marrja në shqyrtim e këtyre pretendimeve u çmua pa vlerë në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi.
34. Sa i takon pretendimit të parashtruar nga subjekti i rivlerësimit në ankim dhe të pasqyruar në paragrafin 32.6 më sipër në këtë vendim, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, konstatoi se, lidhur me verifikimin e mundësisë financiare të dhuruesve (prindërve të subjektit të rivlerësimit) për të blerë pasurinë objekt kontrolli në vitin 2009¹⁵, në çmimin e përcaktuar në kontratë prej 6.845.000 lekësh, subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion justifikues, sikundër nuk rezultoi të jenë marrë të dhëna të vlefshme në këtë drejtim as nga hetimi i kryer kryesisht nga vetë Komisioni. Mosdorëzimi i dokumentacionit justifikues, për të provuar mundësinë e prindërve për krijimin e kësaj pasurie, është konfirmuar edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit me pretendimin e pamundësisë së saj si pasojë e ekonomisë informale. Në këto kushte, referuar legjislacionit të zbatueshëm lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar, sipas të cilit barrën e provës për të provuar bindshëm ligjshmërinë e pasurive të tyre e kanë subjektet e rivlerësimit, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar në parashikimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, konkluzionin e Komisionit se, lidhur me pasurinë objekt kontrolli, të fituar sipas kontratës së dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.10.2012, subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur me të, dhuruesit (prindërit e subjektit të rivlerësimit), nuk kanë arritur të provojnë me dokumentacion justifikues ligjshmërinë e të ardhurave në shumën e 6.845.000 lekëve, të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen prej tyre të pasurisë që i kanë dhuruar subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj në vitin 2012. Për rrjedhojë, trupi gjykues arriti në përfundimin se konkluzioni i Komisionit lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “ambient shërbimi, dyqan” me sip. 44 m², me vendndodhje në rr. “{***}”, Tiranë, mbetet i pacenueshëm.
35. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “ambient shërbimi”, me sipërfaqe 46 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, trupi gjykues, pasi analizoi shkakun e ankimit, konstatoi dhe vlerësoi se:*

¹⁵ Shih kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme (dyqan) me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2009, të lidhur para noteres D. K., mes R. L., F. B. dhe B. L. dhe Sh. C.

36. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendim se, në kuadër të kontrollit të kësaj pasurie: [...] ka konstatuar se ka mospërputhje në deklaratimet kontradiktore të bëra lidhur me shumën e marrë hua në vitin 2015 nga subjekti i rivlerësimit. Trupi gjykues konstaton se, edhe pas kalimit të barrës së provës me dërgimin e rezultateve, subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime bindëse/shteruese lidhur me këtë mospërputhje, për rrjedhojë konfirmohen rezultatet e hetimit administrativ. [...] Komisioni ngriti dyshime të arsyeshme mbi marrëdhënien e qiradhënies mes subjektit, bashkëshortit dhe shtetasit A. Ç., mbi të ardhurat e deklaruara si të përfituara prej saj, përpara datës së nënshkrimit të kontratës së qirasë dhe para regjistrimit të adresës së dyqanit, të ardhura të cilat janë deklaruar si burim krijimi për pasurinë në fjalë. Në këto kushte, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën e sa u analizua dhe detajua më sipër. Edhe pas dërgimit të rezultateve, subjekti nuk arriti të provonte me dokumentacion ligjor, si dhe të shpjegonte bindshëm për të kundërshtuar rezultatet e arritura në hetim, si rrjedhojë trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të shumës prej 500.000 lekësh, të pretenduar si të përfituar nga marrëdhënia e qiradhënies me personin fizik "A. Ç."
37. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me dyshimet e ngritura nga Komisioni sa i takon marrëdhënies financiare të bashkëshortit të saj me z. A. Ç., në kuadër të vlerësimit të burimeve të krijimit të pasurisë objekt kontrolli, është shprehur se, pa dashur të bjerë në përsëritje, rikonfirmon sa parashtruar më sipër në ankimin e saj në lidhje me marrëdhënien mes bashkëshortit të saj dhe z. A. Ç., si dhe se të gjitha provat shkresore i ka paraqitur bashkë me deklaratën vetting me akt noterial. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni, pa të drejtë, ka vënë në dyshim marrëdhëniet financiare dhe ato shoqërore mes bashkëshortit të saj dhe z. Ç., kur ndërkohë sipas saj, ky shtetas ka vepruar me prokurë si përfaqësues i subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj në kryerjen e transaksionit.
38. Subjekti i rivlerësimit, znj. Klorinda Çela, kundërshtoi si të padrejtë dhe të pabazuar mosmarrjen në konsideratë nga Komisioni të huasë së marrë nga bashkëshorti i saj në vitin 2015, dhe pretendoi se Komisioni nuk ka treguar arsyen se pse ka vepruar në këtë mënyrë, duke vënë në dyshim edhe një transaksion financiar të bërë nëpërmjet noterit konform legjislacionit në fuqi. Subjekti pretendoi gjithashtu si të padrejta dyshimet e ngritura nga Komisioni lidhur edhe me marrëdhënien e qiradhënies mes subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj me shtetasin A. Ç..
39. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues vëren fillimisht se Komisioni ka konstatuar mospërputhje në deklaratime lidhur me vlerën e huasë së marrë në vitin 2015 nga prindërit e subjektit të rivlerësimit. Pavarësisht kësaj, në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar edhe analizës financiare të kryer nga Komisioni, rezultoi se huaja është marrë në konsideratë si e hyrë në ekonominë familjare të subjektit të rivlerësimit për vitin 2015, në vlerën prej 14.000.000 lekësh, e cila kishte kaluar nëpërmjet transaksionit përkatës bankar, duke përjashtuar këtu vlerën prej 700.000 lekësh, vlerë kjo që rezultoi se kishte kaluar nga llogaria e z. Sh. Ç. në llogarinë e znj. M. Ç. në Raiffeisen Bank, dhe se në vijim ishte investuar në depozitë me afat – dhe rezultoi të mos ishte tërhequr gjatë vitit 2015 nga ana e tyre. Në këtë kuptim, pretendimet

e ripërsëritura në ankim nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me mosmarrjen në konsideratë nga Komisioni të huasë së marrë nga prindërit e subjektit, çmohen të pabazuara në fakte.

40. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve lidhur me të ardhurat në vlerën prej 500.000 lekësh, të pretenduara si të përfituara nga marrëdhënia e qiradhënies me personin fizik “A. Ç.”, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
41. Në përfundim të hetimit të kryer lidhur me këtë pasuri, Komisionit i rezultoi se ka bërë, ndër të tjera, gjetjen se: *Komisioni ngre dyshime të arsyeshme mbi marrëdhënien e qiradhënies mes subjektit të rivlerësimit e bashkëshortit dhe shtetasit A. Ç., dhe të ardhurat e deklaruara si të përfituara prej saj, përpara datës së nënshkrimit të kontratës së qirasë dhe para regjistrimit të adresës së dyqanit – si adresë sekondare e tatimpaguesit “A. Ç.” person fizik, të ardhura të cilat janë deklaruar si burim krijimi për pasurinë në fjalë. Në përfundim, Komisioni rezultoi t’i ketë kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime/argumente përfundimtare dhe të depozitojë prova të reja të mundshme, për të provuar ekzistencën e marrëdhënies së qirasë me “A. Ç.” person fizik, prej datës 1.5.2015 e në vijim.*
42. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me deklaratën e pasurisë *vetting*, në kuadër të dorëzimit të dokumentacionit justifikues të të ardhurave të deklaruara, ka dorëzuar edhe kontratën noteriale të qirasë, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.07.2015, të lidhur para noteres R. R., mes subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj në cilësinë e qiradhënësve dhe personit fizik “A. Ç.”, identifikuar me NUIS {***}, në cilësinë e qiramarrësit. Sipas kësaj kontrate, qiradhënësit i kanë dhënë me qira qiramarrësit pasurinë në pronësi të tyre, të llojit “Njësi” me sipërfaqe 44 m², në rrugën “{***}”, përkundrejt çmimit mujor të qirasë prej 172.500 lekësh (në vlerë bruto). Referuar parashikimit në këtë kontratë, marrëdhënia e qirasë është përcaktuar me efekt nga data 01.05.2015. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me këtë kontratë, ka dorëzuar edhe një vërtetim të nënshkruar nga z. A. Ç., lidhur me përmbushjen nga ana e tij të detyrimit për mbajtjen dhe pagesën e tatimit të mbajtur në burim, lidhur me të ardhurat nga qiradhënia.
43. Në kuadër të hetimit të kryer nga ana e ILDKPKI-së lidhur me pagesat e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga qiradhënia, rezultoi se në vijim të komunikimeve të zhvilluara me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, pranë së cilës ishte i regjistruar personi fizik “A. Ç.”, referuar komunikimit elektronik të datës 4 shtator 2018, është konfirmuar fakti se: “Personi fizik “A. Ç.”, me NIPT {***}, bazuar në verifikimin e bërë në sistemin c@ats, figuron me deklarata të dorëzuara dhe pagesa të kryera për përgjegjësinë tatimore “Tatim i mbajtur në burim” për periudhën gusht 2015 - janar 2017”. Nga verifikimi i dokumentacionit të përcjellë nga organi tatimor përgjegjës, rezultoi se në pagesën e kryer në muajin gusht, vlera e tatimit të mbajtur në burim është 4 herë më e lartë se ajo e muajve në vazhdim. Gjithashtu rezultoi se nga muaji gusht e në vijim, tatimi është mbajtur për çdo muaj, deri në përfundim të kësaj marrëdhënieje, në janar të vitit 2017, nga ku konstatohet se vullneti kontraktual i palëve mbi kohëzgjatjen e marrëdhënies së qirasë, përputhet me pagesat e kryera sipas kësaj kontrate.

44. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vlerësoi të marrë në konsideratë si një burim të ardhurash me origjinë nga shfrytëzimi real i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, pagesën e kryer nga z. A. Ç. në muajin gusht të vitit 2015, në shumën prej 600.000 lekësh (ku rezultoi të jenë paguar në mënyrë të menjëhershme vlera e qirasë për 4 muaj, që sipas verifikimeve të kryera korrespondojnë me muajt pararendës të datës së pagesës). Ky konkluzion u arrit pasi nga analiza juridike e akteve të sipërcituara, nuk paraqiten problematika, për sa kohë e ardhura nga qiraja provohet të ketë kaluar në favor të qiradhënësve në rrugë bankare, mbi bazën e një kontrate noteriale qiradhënieje dhe mbi këtë të ardhur rezultoi të jenë përmbushur edhe detyrimet tatimore nga personi fizik, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, edhe parashikimi kontraktual se kjo marrëdhënie ka filluar para datës së lidhjes së kontratës, nuk paraqet problematikë nga ana juridike, për sa kohë një marrëdhënie qiraje për periudha më të shkurtra se 1 vit, referuar përcaktimeve të nenit 803 të Kodit Civil, nuk është e detyrueshme të bëhet me kontratë të shkruar. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se z. E. Dh., i cili kishte pasur në përdorim pasurinë objekt kontrolli për ushtrimin e aktivitetit bar kafe, më datën 14.05.2015, kishte bërë kërkesë për çregjistrim, dhe rezultoi të ishte verifikuar nga organi tatimor se nuk e ushtronte më veprimtarinë e tij tregtare në këtë adresë në muajin maj 2015¹⁶.
45. Trupi gjykues vlerëson se Komisioni duhet të kishte mbajtur në konsideratë se për pasurinë objekt qiradhënieje, rezultoi se nuk u arrit të provohen burimet e ligjshme të personave të tjerë të lidhur (prindërve të subjektit të rivlerësimit), për blerjen e kësaj pasurie të dhuruar në vijim subjektit dhe bashkëshortit të saj. Rrjedhimisht, edhe të ardhurat e krijuara nga shfrytëzimi i kësaj pasurie duhet t'i kishte vlerësuar se nuk përmbushin standardin e të ardhurave të ligjshme sipas përcaktimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Por, në kushtet kur Komisioni të ardhurat nga qiradhëniet e kësaj pasurie i ka verifikuar vetëm në drejtim të ekzistencës së tyre dhe përmbushjes së detyrimeve tatimore, duke arritur në konkluzion mbi paligjshmërinë e këtyre të ardhurave vetëm mbi bazën e këtyre elementeve dhe jo të origjinës së pronës nga e cila kanë rrjedhur, në konsideratë edhe të faktit se këto të ardhura vetë Komisioni rezultoi t'i ketë përfshirë si të hyra në ekonominë familjare në analizën financiare të vitit 2015, trupi gjykues, nisur nga parimi i mosrëndimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit çmoi t'i marrë në konsideratë këto të ardhura si burim për pagesën e deklaruar prej 500.000 lekësh, lidhur me krijimin e pasurisë së paluajtshme të llojit “njësi” me sipërfaqe 46 m², në rrugën “{***}”, Tiranë.
46. Lidhur me 2 pasuritë e paluajtshme të llojit “garazh”, të blera në vitin 2015, me vendndodhje në rrugën “{***}”, Tiranë, trupi gjykues, pasi analizoi shkakun e ankimit, konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
47. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e këtyre dy pasurive, ka arritur në konkluzionin se: *subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e pasurive në analizë, pasi ka rezultuar një mungesë financiare prej 1.515.198 lekësh.* Këtë konkluzion, Komisioni duket ta

¹⁶ Shiko informacionin e përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore e Tiranës me nr. {***} prot., datë 17.06.2021.

ketë arritur pasi ka vlerësuar se edhe pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime dhe nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar se të ardhurat e deklaruar si të përfituara nga qiradhënia e lokalit gjatë vitit 2015, ishin të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, madje ka pohuar se nuk mund të provonte këtë fakt për shkak të informalitetit.

48. Lidhur me krijimin e këtyre dy pasurive, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi në ankim si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për mosdeklarim (fshehje) të dy garazheve, duke pretenduar se ajo dhe bashkëshorti i saj i kanë deklaruar ato në deklaratën e pasurisë *vetting*.
49. Subjekti kundërshtoi gjithashtu analizën financiare të kryer lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme për krijimin e këtyre dy pasurive, si të bazuar në hamendësime dhe joobjektive. Sipas subjektit, është e pakuptueshme se përse në këtë analizë janë marrë vetëm të ardhurat nga pagat e saj dhe të bashkëshortit të saj për periudhën 01.01.2015 – 10.04.2015, ndërkohë që, sipas saj, ajo dhe bashkëshorti i saj kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e dy pasurive objekt kontrolli. Sipas subjektit të rivlerësimit, analiza financiare e Komisionit është e njëanshme dhe e pabazuar në të ardhurat reale dhe të dokumentuara të subjektit dhe bashkëshortit të saj. Subjekti prapësoi se i vetmi problem në burimet e krijimit të këtyre dy pasurive, mbetet provimi i ligjshmërisë së burimit në kushtet e një ekonomie informale dhe emigracionit të paligjshëm të të afërmeve.
50. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues vëren fillimisht se Komisioni, në përfundim të procesit të verifikimit të ligjshmërisë së krijimit të këtyre dy pasurive të paluajjtshme, pavarësisht konstatimeve në lidhje me problematika në deklaratimet e kryera në deklaratat periodike vjetore për vitet 2015 dhe 2016 para ILDKPKI-së, nuk rezulton të ketë arritur në konkluzion për mosdeklarim apo fshehje të këtyre pasurive në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, rrjedhimisht edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim konstatohen të pabazuara.
51. Në lidhje me pretendimet e ngritura në kundërshtimin e analizës financiare të kryer nga Komisioni për vlerësimin e mundësisë ekonomike të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj për krijimin e këtyre dy pasurive, trupi gjykues, pasi kontrolloi nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor analizën e Komisionit, konstatoi se kjo analizë është kryer duke mos marrë në konsideratë kursimet gjendje *cash* të akumuluar, me arsyetimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar në deklaratën periodike përkatëse pakësimin e gjendjes *cash*. Ky qëndrim i Komisionit u gjet i drejtë dhe i bazuar në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ dhe në përputhje me jurisprudencën orientuese të Kolegjit mbi mospërdorimin e likuiditetit gjendje *cash* në rastet kur këto likuiditete as janë deklaruar si të pakësuar, as janë deklaruar si burim për krijimin e pasurive objekt kontrolli¹⁷.

¹⁷ Shih vendimin e Kolegjit nr. (JR) 7/2019.

52. Gjithashtu, edhe sa i përket mosmarrjes në konsideratë nga ana e Komisionit të të ardhurave të deklaruar si të përfituara gjatë vitit 2015, në shumën 600.000 lekë nga E. Dh., nga qiradhënia e njësisë me sip. 44 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, me arsyetimin se për këto të ardhura, subjekti i rivlerësimit nuk dorëzoi asnjë dokumentacion justifikues për të vërtetuar shlyerjen e detyrime tatimore përkatëse, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, e gjeti të drejtë dhe të bazuar në fakte këtë qëndrim të Komisionit. Trupi gjykues vëren se vetë subjekti i rivlerësimit e ka pranuar këtë fakt, duke pretenduar ekonominë informale si justifikim të mungesës së të provuarit të këtij fakti. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se të ardhurat e deklaruar si të realizuara nga qiradhënia e njësisë për vitin 2015, nuk përmbushin standardin e të ardhurave të ligjshme në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe, si të tilla, me të drejtë nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni në analizën e kryer për verifikimin e burimeve të ligjshme për blerjen e dy garazheve.
53. Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues arriti në të njëjtin konkluzion si Komisioni, se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk arritën të përmbushin detyrimin kushtetues të parashikuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës, për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruar, duke rezultuar edhe pas kontrollit të ushtruar në Kolegj, në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme në shumën e (-) 1.515.198 lekëve, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për krijimin e dy pasurive të paluajtshme të llojit “garazh”, me sipërfaqe 18,9 m² dhe 18,2 m², me vendndodhje në rrugën “{***}”, Tiranë, të blera në vitin 2015 në shumën 9.000 euro.
54. Lidhur me pasuritë e blera nga shoqëria {***} në vitin 2015, trupi gjykues, pasi analizoi shkakun e ankimit, konstaton dhe vlerëson si më poshtë.
55. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklarimit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive, lidhur me pasurinë “Njësi shërbimi me sipërfaqe 47 m²”, prenotuar sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.07.2015, ka arritur në konkluzionin se: *si burim për pagesën e kryer për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, kanë shërbyer të ardhurat e marra hua nga prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, ligjshmëria e të cilave është analizuar si më sipër në këtë vendim.* Përpos kësaj, Komisioni thekson faktin se në deklaratën vetting, subjekti nuk ka deklaruar saktësisht burimin e krijimit të kësaj pasurie.
56. Ndërkohë, sa u takon 3 pasurive të tjera të llojit “njësi shërbimi” me sipërfaqe respektivisht 47,23 m², 42,62 m² dhe 98,33 m², objekt i kontratës me nr. {***} rep., {***} kol., datë 16.07.2015, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: *subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e kësaj të parë për likuidimin e çmimit të pasurive objekt vlerësimi, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. [...] Komisioni ka konstatuar gjithashtu se gjatë viteve 2016 – 2017, janë depozituar cash nga persona të tretë vlera monetare për shlyerjen e kësteve të kredisë, të marrë nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në OTP Bank. Pasi ka konstatuar se fondet e depozituara/të*

transferuara nga persona të tretë kanë shërbyer për shlyerjen e kredisë së marrë nga subjekti dhe bashkëshorti, në referim të pikës 14 të nenit 3, si dhe të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka arritur në përfundimin se këta persona bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast të provojnë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumave të depozituara apo të transferuara në llogarinë bankare të personit të lidhur.

57. Në vijim të këtij konkluzioni, Komisioni ka arsyetuar se në kushtet kur subjekti nuk paraqiti gjatë procesit të rivlerësimit në Komision asnjë dokumentacion ligjor justifikues, në konsideratë edhe të faktit se nuk ka deklaruar ndër vite hua/të apo dhurim/et nga shtetasit e sipërcituar, që lidhen me këto depozitime apo transfertat bankare, shoqëruar dhe me faktin se shtetasit e mësipërm nuk kanë konfirmuar marrëdhënie huaje apo dhurimi, si dhe për aq kohë sa nuk është depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e tyre, e gjithë vlera e kredisë së shlyer është konsideruar në analizën financiare si shumë e paguar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur. Në përfundim, Komisioni ka konkluduar se lidhur me këto pasuri, *konfirmohet pamundësia financiare me burime të ligjshme sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, përkatësisht, në vlerat negative 15.105.273 lekë në vitin 2015 dhe 3.520.498 lekë për vitin 2016.*
58. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pagesën e këstit të parë për blerjen e pasurive objekt kontrolli në vlerën e (-) 15.105.273 lekëve. Subjekti i rivlerësimit është shprehur se *nuk e kuptoj pse duhet të dilni në përfundimin që kjo pasuri është blerë e ndërtuar plotësisht kur ajo dhe sot e kësaj dite nuk i ka të gjithë aksesoret që ka një ambient shërbimi i ndërtuar plotësisht.* Subjekti pretendon se në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka pasqyruar identitetin e shtetasve lidhur me transaksionet për blerjen e kësaj pasurie, si dhe se ka depozituar të gjitha provat e nevojshme lidhur me to. Subjekti pretendon se as ajo dhe as bashkëshorti i saj nuk kanë pasur gjykime me palë shtetasit e përfshirë në këto veprime financiare, duke pretenduar se burimi i të ardhurave është tërësisht i ligjshëm dhe i pasqyruar në deklaratën e pasurisë *vetting*.
59. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vëren se sa i takon konkluzionit lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme financiare për shlyerjen e këstit të parë, referuar analizës së kryer nga Komisionit për vitin 2015, si dhe pagesës së këstit II dhe III, referuar analizës financiare të kryer për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë kundërshtim, argumentim, pretendim apo çfarëdo parashtrim faktesh apo arsyetimi i cili të kërkojë një vlerësim juridik në kuadër të kontrollit të vendimmarrjes së Komisionit lidhur me vlerësimin e këtyre pasurive. Për rrjedhojë, referuar situatës faktike të parashtruar në vendimin objekt ankimi në faqet 19-24, e cila nuk rezulton të jetë kundërshtuar në ankim nga ana e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se konkluzioni për verifikimin e burimeve të ligjshme të krijimit të 3 pasurive objekt i kontratës nr. {***} rep., {***} kol., datë 16.07.2015, sipas çmimit të plotë të përcaktuar në kontratë, prej 246.429 eurosh, gjendet i drejtë dhe rrjedhimisht mbetet i pacenuar.

60. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se gjatë viteve 2016 – 2017, janë depozituar *cash* nga persona të tretë vlera monetare për shlyerjen e kësteve të kredisë të marrë nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në OTP Bank, konkretisht nga shtetasit: M. Ç. në shumën 2.475.000 lekë; E. M. në shumën 165.000 lekë; F. M. në shumën 165.000 lekë; H. M. në shumën 165.000 lekë; dhe A. Ç. në shumën 527.000 lekë, trupi gjykues e gjeti të drejtë dhe të bazuar konkluzionin e Komisionit për verifikimin e këtyre transaksioneve sipas kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke u dhënë këtyre personave cilësinë e personave të tjerë të lidhur dhe, rrjedhimisht, duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, ndër të tjera edhe për të provuar me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave të këtyre shtetasve, për të justifikuar shumat e depozituara/transferuara në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit.
61. Lidhur me sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, znj. Klorinda Çela, në prapësimet e saj ndaj rezultateve të hetimit si dhe në ankim, është shprehur se shtetasit M. Ç., E. M., F. M., H. M. janë punonjës të kompanisë së nënës së subjektit të rivlerësimit, znj. M. Ç., në të cilën, sipas saj, ka qenë pjesëtar edhe vëllai A. Ç., të cilit i ka kërkuar të paguajë këstin e kredisë dhe ky i fundit, sipas subjektit, ua ka deleguar këtë punonjësve të tjerë. Subjekti ka pretenduar se këta persona nuk i njeh dhe nuk ka pasur asnjëherë gjykime për çështje ku ata të kenë qenë palë. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar konkluzionin e Komisionit për përfshirjen në analizën financiare të të gjithë vlerës së kredisë së shlyer si shumë të paguar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të.
62. Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues arriti në të njëjtin konkluzion si Komisioni, se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk arritën të përmbushin detyrimin kushtetues të parashikuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës, për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara, duke rezultuar edhe pas kontrollit të ushtruar në Kolegj në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 15.105.273 lekë për vitin 2015 dhe në shumën (-) 3.520.498 lekëve për vitin 2016, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për krijimin e tri pasurive të paluajtshme të llojit “njësi shërbimi” me sipërfaqe totale 188,18 m², me vendndodhje në rrugën “{***}”, Tiranë, të porositura në vitin 2015, në shumën 246.429 euro.
63. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “ndërtim informal” me sip. 70 m², në proces legalizimi, në rrugën “{***}”, Tiranë, në emër të vjehrrit të subjektit të rivlerësimit, z. V. Dh., subjekti ka pretenduar se dyshimi i Komisionit se kjo pasuri nuk është e vjehrrit të saj V. Dh., është i pabazuar, duke u shprehur konkretisht: *Nuk e kuptoj se çfarë baze ka dyshimi juaj se kjo pronë nuk është e vjehrrit tim V. Dh.?**
64. Trupi gjykues konstaton se Komisioni, në kuadër të vlerësimit të kësaj pasurie të përfshirë në deklaratën e pasurisë *vetting*, në vendimin e tij ka arritur në konkluzionin se: *Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, trupi gjykues, pasi analizoi rrethanat dhe faktet mbi këtë pasuri, si dhe dokumentacionin e administruar në dosje, arrin në përfundimin se subjekti nuk zotëron pjesë*

takuese mbi këtë objekt dhe se nuk ka dyshime se ajo mund të ketë kontribut në krijimin e kësaj pasurie.

65. Në këto kushte, trupi gjykues, përveçse nuk vlerëson se sa referuar në ankim nga subjekti i rivlerësimit ngrihet në nivelin e një shkaku ligjor për kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit lidhur me pasurinë objekt kontrolli, për më tepër, në konsideratë të konkluzionit të Komisionit për këtë pasuri, sipas të cilit nuk krijohet asnjë pasojë juridike në dëm të subjektit të rivlerësimit, qëndrimi i kësaj të fundit në ankim duket i pakuptimtë dhe pa relevancë në shqyrtimin e këtij ankimi.
66. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament” me sipërfaqe 190 m², me vendndodhje Shëngjin, për të cilën subjekti i rivlerësimit pretendoi se konkluzioni i Komisionit është i pabazuar, trupi gjykues, pasi analizoi shkakun e ankimit, konstatoi dhe vlerësoi si vijon.*
67. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me vlerësimin e pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament” me sipërfaqe 190 m², me vendndodhje në Shëngjin, pasi konstatoi se subjekti nuk e kishte deklaruar këtë pasuri as në deklaratën e pasurisë *vetting* e as në deklaratat periodike para ILDKPKI-së të viteve 2011, 2012, 2013, ka arritur në përfundimin se: *apartamenti me sip. 190 m², ndodhur në Shëngjin, Lezhë, është pasuri e porositur dhe e paguar nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, me qëllim përdorimin, disponimin dhe gëzimin e plotë nga ana e tyre, por, në vijim, kanë transferuar të drejtat e kësaj pasurie tek i vëllai i bashkëshortit, z. E. Dh., të cilat duken se janë kryer me qëllim shmangien e kontrollit dhe verifikimit të ligjshmërisë së burimeve financiare, që kanë shërbyer për pagesën/pagesat e kryera. Nisur nga sa më sipër është evidentuar, trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të rrethanave dhe fakteve të mësipërme, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë dhe, si rrjedhojë, gjendet në kushtet e germës “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni, në vlerësim të rrethanave dhe fakteve të konstatuara dhe duke marrë në konsideratë faktin se si gjatë hetimit administrativ, por edhe gjatë dërgimit të rezultateve, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e këstit të parë për prenotimin e pasurisë në fjalë, pasi ka rezultuar me një mungesë të mjeteve financiare prej 6.977.770 lekësh, në vitin 2011, duke u gjendur edhe në kushtet e germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*
68. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë pasuri dhe pretendoi se pronar i vetëm dhe i vërtetë i kësaj pasurie është kunati i saj E. Dh. dhe se bashkëshorti i saj ka shpjeguar arsyet se pse kjo pasuri ishte lidhur fillimisht në emër të tij. Në mbështetje të këtij shkaku ankimi, subjekti pretendoi se konstatimi i Komisionit lidhur me daljen për herë të parë të z. E. Dh. jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në datën 25.5.2011, është i pavërtetë. Sipas saj, shtetasi E. Dh. ka qenë emigrant për vite me radhë që nga viti 1994 në Greqi, si dhe ka qenë edhe në shumë shtete të tjera ku ka jetuar dhe ka lidhur martesë. Sipas subjektit të rivlerësimit, të ardhurat e kunatit të saj janë të akumuluar përgjatë viteve të punës në emigracion dhe brenda vendit dhe se ai nuk është akuzuar ndonjëherë për kryerjen e ndonjë vepre penale.

69. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi gjithashtu si joprofesionale dhe tërësisht të pakuptueshme kryerjen e analizës financiare lidhur me krijimin e kësaj pasurie mbi bazën e të ardhurave të një muaji, ndërkohë që, sipas subjektit, kjo pasuri është e kunitit.

70. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, konstatoi si më poshtë.

70.1. Në DIPPV-në e vitit 2013, në fund të faqes 15 të kësaj deklaratë, subjekti i rivlerësimit është shprehur se: “Bashkëngjitur keni dhe një Observacion”. Referuar dokumentacionit të administruar nga ILDKPKI-ja, me kërkesë të Komisionit, rezulton se në Observacionin bashkëlidhur DIPPV-së së vitit 2013, subjekti i rivlerësimit është shprehur: *Midis bashkëshortit tim (K. Dh.) dhe shoqërisë “{***}” ShPK është lidhur një kontratë sipërmarrje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.02.2011, e cila është lidhur në kushtet e fiktivitetit, sepse qëllimi i kësaj kontrate ishte prenotimi i një hyrjeje të ndërtuar nga shoqëria në fjalë, në Shëngjin, për vëllain e tij E. Dh., i cili në atë kohë ndodhej në Greqi. Kjo kontratë sipërmarrjeje nuk është deklaruar për vitin 2011, sepse është konsideruar nga bashkëshorti si një veprim juridik i pavlefshëm i lidhur mes tij dhe shoqërisë në fjalë. Kjo provohet dhe me deklaratën e bërë mes bashkëshortit tim dhe shoqërisë në fjalë, më datë 19.10.2013, dhe lidhjes së kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.10.2013, me vëllain e tij E. Dh., të ardhur nga Greqia, lidhur me të njëjtin objekt. Vullneti real për lidhjen e kontratës së sipërmarrjes midis vëllait të bashkëshortit tim dhe shoqërisë është shprehur dhe nga vetë shoqëria ndërtuese dhe prej bashkëshortit, që kanë revokuar kontratën e sipërmarrjes.*

70.2. Pjesë e dokumentacionit të përcjellë nga ILDKPKI-ja me kërkesë të Komisionit janë edhe:

(i) Kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 3.2.2011, lidhur para noterit V. M. nga shoqëria “{***}” ShPK dhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. K. Dh., me objekt: *[...] porositja e një apartamenti në godinën e banimit nr. {***} që do të ndërtohet nga sipërmarrësi [...] dhe përkatësisht: “apartamenti nr. {***}, shkalla nr. {***}, kati i {***} i banimit, me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi 109 m²” në objektin që do të ndërtonte kjo shoqëri, në Shëngjin, Lezhë, për çmimin prej 60.000 eurosh. Në këtë kontratë është referuar plani i pagesave si vijon: (i) kësti i parë në shumën prej 50.000 eurosh është likuiduar paraprakisht; dhe (ii) diferenca e mbetur do të paguhet me përfundimin e objektit.*

(ii) Deklarata noteriale “Për prishje kontrate” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.10.2013, para noterit publik V. M., me anë të së cilës shoqëria “{***}” ShPK dhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit kanë deklaruar se në datën 3.2.2011, ata kanë nënshkruar kontratën e sipërmarrjes për porositjen e ndërtimit të apartamentit në objektin që shoqëria “{***}” po ndërton në Shëngjin, Lezhë. Z. Dh. ka deklaruar se *ky apartament është porositur nga ai formalisht, në mungesë të vëllait të tij, i cili ishte emigrant me dokumente në Greqi dhe në kohën e përpilimit dhe nënshkrimit të kontratës, ai nuk kishte mundësi të ishte prezent në nënshkrimin e kontratës. Z. Dh. deklaroi se: kjo kontratë është nënshkruar prej tij, por edhe shoqëria “{***}” ShPK, në kohën e nënshkrimit të saj është vënë në dijeni që, me të ardhur në Shqipëri vëllai i tij, ata do të bëjnë revokimin e*

kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 3.2.2011, dhe do ta lidhin me vëllain e tij, dhe të gjithë të drejtat e fituara nga ana e K. Dh. sipas kontratës së mësipërme do t'i kalojnë vëllait të tij në kontratën e re që palët do nënshkruajnë me njëri-tjetrin. Gjithashtu, nga ana e shoqërisë, do të njihen të gjitha pagesat e kryera deri në këtë moment dhe nuk ndryshon asgjë nga kushtet e kontratës me K. Dh. me kontratën e E. Dh.. Ai deklaron se heq dorë nga çdo e drejtë pronësie dhe pretendim ndaj pasurisë apartament me sipërfaqe 109 m², e ndodhur në katin e tetë, shkalla {***}, ap. {***}, në objektin që shoqëria “{***}” ShPK ka ndërtuar në Shëngjin. Shoqëria “{***}” ShPK ka deklaruar se heq dorë nga kontrata e parë e sipërmarrjes, cituar më sipër, dhe gjithë pagesat e saj i kalon për llogari të kontratës që do të nënshkruajnë me shtetasin E. Dh. dhe këtë kontratë do ta nënshkruajnë po sot.

(iii) Kontrata e sipërmarrjes për ndërtim apartamenti, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.10.2013, është lidhur para noterit publik V. M., mes shoqërisë “{***}” në cilësinë e sipërmarrësit dhe z. E. Dh. (vëllai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit) në cilësinë e porositesit. Sipas kësaj kontrate, e cila ka parashikime pothuajse identike në përmbajtje me atë të lidhur mes shoqërisë ndërtuese dhe z. K. Dh., palët kanë rënë dakord për: *porositjen e një apartamenti në godinën e banimit që do të ndërtohet nga sipërmarrësi dhe përkatësisht: apartamenti nr. {***}, shkalla nr. {***} me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi 109 m², të ndodhur në katin e {***} banim, godina nr. {***},* ndërkohë që konstatohet se pasuria e evidentuar në kontratën e sipërmarrjes së lidhur nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në datën 3.2.2011, i përkiste godinës nr. {***}.

71. Gjatë procesit të hetimit në Komision, subjekti i rivlerësimit është pyetur nga ky i fundit në pyetësorin nr. 2, të datës 13.07.2021, lidhur me dhënien e shpjegimeve mbi mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratën periodike të vitit 2011, si dhe lidhur me burimet e ligjshme të të ardhurave në vlerën e 50.000 eurove që i takojnë kështit të parë të apartamentit të paguar nga bashkëshorti i subjektit në vitin 2011. Në përgjigjen e saj lidhur me pyetjen 22 të këtij pyetësi, subjekti është shprehur: *Kësaj pyetjeje i është dhënë përgjigje në deklaratimet periodike vjetore dhe në deklaratën vetting. Kjo pronë është në pronësi të shtetasit E. Dh.. Ai mund të tregojë burimin e ligjshëm i cili ka 20 vjet në emigracion.*
72. Gjithashtu, edhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. K. Dh., i pyetur nga Komisioni lidhur me porositjen e kësaj pasurie, ka dhënë këto shpjegime në përgjigje të pyetjes nr. 15.1¹⁸ të

¹⁸ Komisioni rezulton ta ketë pyetur bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit lidhur me sa vijon:

“15.1 Nisur nga fakti që në datë 29.10.2013, është lidhur një tjetër kontratë sipërmarrjeje për të njëjtën pasuri, por me porosites shtetasin E. Dh. (vëllain tuaj) dhe sipërmarrës shoqërinë “S. C.” ShPK, kërkohet të na deklaroni:

a) Cila ka qenë gjendja e objektit (në ç’fazë ndërtimi ka qenë) në datë 29.10.2013?

b) A kishit paguar ju pjesën e mbetur prej 10.000 eurosh nga çmimi përfundimtar?

c) Kur dhe në ç’mënyrë (cash apo nëpërmjet bankës) iu është kthyer nga vëllai juaj shuma prej 50.000 eurosh (që keni paguar në vitin 2011) ose ndonjë shumë tjetër e paguar nga ju për këtë pasuri deri në datë 29.10.2013?

ç) Përse nuk është deklaruar nga ana juaj në deklaratën përkatëse të interesave private në ILDKPKI, kthimi i pretenduar i të drejtave për këtë pasuri, si dhe kthimi i shumës së pretenduar të paguar për vëllain tuaj?

pyetësorit nr. 2 të Komisionit: a) *Nuk e di e nuk kam si ta di gjendjen e kësaj pasurie në datën 29.10.2013 pasi ajo është një pasuri e vëllait tim. b) dhe c) Unë vetë personalisht nuk kam bërë asnjë pagesë dhe nuk më është kthyer asnjë pagesë nga vëllai im. ç) Në ILDKPKI kam deklaruar çdo gjë për të cilën unë isha i detyruar në bazë të ligjit. Sqarimin për këtë çështje e kam bërë tek ILDKPKI-ja në momentin e duhur. d) As unë, as bashkëshortja ime, në dijeninë time, nuk kanë pasur çështje për gjykim ku të jenë trajtuar nga ne. Madje shumë më vonë kam mësuar se kush ishin ortakët e vërtetë të kësaj shoqërie. Ky fakt mund të vërtetohet lehtësisht.*

73. Nga verifikimi i kryer nga Komisioni në sistemin TIMS, ka rezultuar se shtetasi E. Dh. ka qenë në territorin shqiptar në datën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes mes bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}” ShPK (datë 3.2.2011). Sipas Komisionit, duket se referuar këtyre të dhënave të sistemit TIMS, dalja e parë e këtij shtetasi jashtë territorit shqiptar ka qenë në datën 25.5.2011 (kjo sa i takon periudhës për të cilën sistemi TIMS disponon të dhëna)¹⁹.
74. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vlerësoi fillimisht se qëndrimi i Komisionit për kryerjen e analizës financiare lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme për kryerjen e pagesës së kështit të parë sipas kontratës së porosisë së lidhur nga ana e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në vitin 2011, gjendet i drejtë dhe i bazuar në fakte. Nga kontrolli i ushtruar analizës financiare të kryer nga Komisioni, lidhur me burimet e financimit të subjektit për pagesën e kështit të parë të këtij apartamenti në vlerën 50.000 euro, e cila, sipas kontratës së sipërmarrjes, është kryer në momentin e nënshkrimit të saj, më datë 03.02.2011, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare për të përballuar këtë investim, duke rezultuar në një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën (-) 6.977.770 lekë.
75. Në analizë të akteve noteriale lidhur me këtë pasuri, si referuar më sipër, trupi gjykues vëren se ato nuk konfirmojnë pretendimet e subjektit të rivlerësimit se kontrata është lidhur në emër të bashkëshortit të saj, por për llogari të vëllait të këtij të fundit. Ky konkluzion vjen si rrjedhojë e konstatimit se në kontratën e sipërmarrjes së lidhur në vitin 2011, jo vetëm që nuk referohet ndonjë akt përfaqësimi i cili të provonte pretendimin e subjektit të rivlerësimit për lidhjen e kontratës nga bashkëshorti i saj për llogari të kunatit, por nuk rezulton as që marrëveshja e pretenduar se ekzistonte që në momentin e nënshkrimit të kontratës në vitin 2011, mes porositësit (bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit) dhe shoqërisë sipërmarrëse, *se me të ardhur në Shqipëri vëllai i porositësit, ata do të bëjnë revokimin e kontratës së sipërmarrjes*, nuk rezulton as të jetë përmendur në kontratën e lidhur në shkurt të vitit 2011 dhe as rezulton që në po këtë periudhë të jetë bërë ndonjë deklaratë e ngjashme noteriale si ajo e nënshkruar në vitin 2013 mes të njëjtave palë. Trupi

d) *Cila ka qenë marrëdhënia juaj me përfaqësuesit/ortakët e shoqërisë “{***}” ShPK?*

dh) *Të na konfirmoni, nëse ju apo bashkëshortja juaj ka gjykuar çështje gjyqësore civile/penale, me palë ndërgjyqëse/kallëzues/të kallëzuar/të pandehur/të dëmtuar etj., shoqërinë “{***}” ShPK, përfaqësuesit/ortakët e saj apo shoqëri të tjera me të njëjtët përfaqësues/ortakë?*

➤ *Në mbështetje të deklaramit tuaj, depozitoni dokumentacion justifikues ligjor”.*

¹⁹ *Për më tepër, Komisioni evidentoi se në datë 4.3.2011, z. E. Dh. ka depozituar cash në llogarinë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank, shumën prej 128.400 lekësh, me përshkrimin “E. Dh. derdh këst kredie”.*

gjykues vëren gjithashtu se edhe në kontratën e sipërmarrjes të lidhur në vitin 2013 mes të njëjtës shoqëri ndërtuese dhe vëllait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, nuk rezulton asnjë parashikim i cili të lidhë këtë kontratë me kontratën e mëparshme të sipërmarrjes dhe kalimin nga njëra palë te tjetra e të drejtave dhe detyrimeve të krijuara sipas marrëdhënies kontraktuale të vitit 2011, të ekzekutuar tashmë në periudhën e lidhjes së kontratës së dytë të sipërmarrjes në vitin 2013. Përpos sa më sipër, edhe pasuritë objekt i këtyre kontratave të sipërmarrjeve u konstatuan t'i përkisnin dy godinave të ndryshme.

76. Këto konstatime lidhur me rrethanat faktiko-juridike të vendosura në kontekstin e një dinamike ndërveprimesh mes ILDKPKI-së dhe bashkëshortëve Dh.-Ç., në kuadër të kontrollit të ushtruar nga ILDKPKI-ja ndaj deklaratave të tyre periodike të viteve 2003-2011, të cilat konfirmohen nga (i) Observacionet e datës 02.02.2012 të Klorinda Çela dhe K. Dh., në përgjigje të kërkesës së ILDKPKI-së; (ii) shkresës së K. Dh. dhe Klorinda Çela me lëndë “Kthim përgjigje” dhe dorëzuar në ILDKPKI më datë 07.09.2012 dhe që kanë kulmuar më datë 24.03.2014, me “Kallëzimin për ndjekje penale ndaj shtetasve K. Dh. me funksion gjyqtar dhe Klorinda Çela me funksion gjyqtare” për veprat penale të parashikuara nga nenet 257/a, paragrafi i dytë i Kodit Penal “Fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi që ka detyrim për deklarim”, në vlerësim të trupit gjykues me të drejtë kanë ngritur dyshimin e arsyeshëm te Komisioni se deklarata noteriale e vitit 2013, mes shoqërisë sipërmarrëse “{***}” ShPK dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për revokimin e kontratës së sipërmarrjes së vitit 2011, si dhe kontrata noteriale e sipërmarrjes e lidhur nga vëllai i këtij të fundit me të njëjtën shoqëri sipërmarrëse në të njëjtën datë, janë bërë me qëllim për të *transferuar të drejtat e kësaj pasurie tek i vëllai, z. E. Dh.– në dukje me qëllim shmangien e kontrollit dhe verifikimit të ligjshmërisë së burimeve të cilat kanë shërbyer për pagesën/pagesat e kryer/a për likuidimin e çmimit të blerjes*. Këto akte, në vijim, rezultojnë të jenë deklaruar para ILDKPKI-së për herë të parë nëpërmjet Observacionit bashkëlidhur DIPPV-së së vitin 2013 (praktikisht në datën 31.03.2014, disa ditë më vonë nga kallëzimi penal i ILDKPKI-së ndaj subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj).
77. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, edhe pas kontrollit të ushtruar në Kolegj mbi bazën e shkaqeve të paraqitura në ankim, nuk arritën të cenojnë konkluzionet e Komisionit se, përveçse me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, janë ndodhur edhe në kushtet e fshehjes së pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament” me sipërfaqe 109 m², me vendndodhje në Shëngjin, porositur në vitin 2011, për një çmim prej 60.0000 eurosh, të likuiduar në po atë vit nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit K. Dh., në shumën prej 50.000 eurosh, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronjat “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016.
78. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “njësi” me sipërfaqe 124 m², me vendndodhje në rrugën “{***}”, Tiranë, për të cilën subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit, trupi gjykues, pasi analizoi shkakun e ankimit, konstatoi dhe vlerësoi si vijon.*

79. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramentit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se: *nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit nëpërmjet prapësimeve, pasi është njohur me rezultatet e hetimit, nuk dha shpjegime dhe nuk paraqiti dokumentacion ligjor shtesë për të kundërshtuar gjetjet e Komisionit, si përfundim, trupi gjykues i qëndron konstatimit dhe rezultatit fillestar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare për të justifikuar pagesat e kryera gjatë vitit 2009, ku rezultoi një bilanc negativ prej 11.498.687 lekësh dhe gjatë vitit 2010, ku rezultoi një bilanc negativ prej 6.245.124 lekësh dhe po gjatë vitit 2010 likuidimi i çmimit për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, sikurse nuk ka pasur burime të ligjshme as personi në emër të të cilit ishte regjistruar kjo njësi tregtare, e vlerësuar nga Komisioni si pasuri e fshehur prej saj dhe bashkëshortit të saj - duke u gjendur edhe në kushtet e gremës "b", të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.*
80. Subjekti i rivlerësimit, znj. Klorinda Çela, lidhur me konkluzionin e Komisionit për këtë pasuri, ka prapësuar se e gjithë kredia e marrë dhe e paguar nga shtetasi A. Ç. (vëllai i subjektit) është marrë me qëllim pagesën e vlerës së ambientit të shërbimit i cili është i regjistruar në emër të këtij të fundit, i cili e posedon dhe e gëzon lirisht atë. Subjekti ka pretenduar në ankim se në deklarament periodike vjetore dhe në deklaratën *vetting* ka deklaruar se së bashku me bashkëshortin kanë lidhur me Raiffeisen Bank një kontratë dorëzanie për kredimarrësin A. Ç. dhe shprehet se nuk e kupton pse anashkalohet ky fakt. Subjekti pretendoi se qenia dorëzanës në një kontratë kredie nuk të bën automatikisht kredimarrës, por vetëm në momentin që kredimarrësi nuk paguan kredinë. Sipas subjektit është krejtësisht normale që dikush të dalë dorëzanës për të vëllanë.
81. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke e bazuar atë në përlllogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera për një periudhë kohore prej dy apo tre muaj me pretendimin se viti ka 12 muaj. Sipas subjektit të rivlerësimit, lidhur me të gjithë personat e lidhur në këtë transaksion, janë bërë deklaramentet përkatëse dhe është paraqitur i gjithë dokumentacioni shkresor me akt noterial së bashku me deklaratën e pasurisë *vetting*. Gjithashtu, subjekti parashtroi në mbështetje të sa më sipër edhe faktin se ajo dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur gjykime me personat e përfshirë në këto transaksione, rrjedhimisht pretendoi se nuk është ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit. Sa i takon dhurimeve dhe sponsorizimeve nga personat e lidhur, subjekti i rivlerësimit pretendoi se janë paraqitur të gjithë dokumentet provuese për ekzistencën e tyre, janë deklaruar rregullisht dhe të gjithë personat kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për shumat e dhëna.
82. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues fillimisht vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë shkak ligjor në ankimin e saj për të kundërshtuar konkluzionin e Komisionit se pasuria objekt kontrolli vlerësohet prej këtij të fundit "*si pasuri e fshehur prej saj dhe bashkëshortit të saj*", duke sjellë si pasojë moscenimin e këtij konkluzioni.
83. Lidhur me pretendimet e subjektit mbi statusin e saj dhe të bashkëshortit të saj si dorëzanës në një kontratë kredie të marrë nga i vëllai pranë Raiffeissen Bank, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e

fashikullit të çështjes, e gjeti të pabazuar në fakte këtë pretendim. Në arritjen e këtij konkluzioni trupi gjykues mbajti në konsideratë se nga shqyrtimi i dokumentacionit bankar²⁰ të administruar gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se në datën 02.10.2010 midis Raiffeisen Bank, subjektit të rivlerësimit në cilësinë e kredimarrësit, bashkëshortit të saj në cilësinë e bashkëkredimarrësit dhe P.²¹ e M. K. në cilësinë e hipotekuesve, është lidhur kontrata e kredisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., për dhënien e kredisë në shumën 10.500.000 lekë për një afat 15 vjeçar, me qëllim përdorimi “Konsumatore me hipotekë”. Kjo kredi është çelur në datë 08.10.2010, në shumën 10.500.000 lekë dhe në datën 11.10.2010 shuma prej 2.000.000 lekësh është tërhequr *cash* nga subjekti i rivlerësimit dhe pjesa tjetër prej 7.800.000 lekësh është transferuar prej saj në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, me përshkrim “pagesë detyrimi”. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se, vëllai i subjektit të rivlerësimit, i cili ndër të tjerë ka kryer edhe pagesa për likuidimin e kësaj kredie (të marrë nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj), në marrëdhënien e kredisë të krijuar me Raiffeisen Bank për porositjen e pasurisë së paluajtshme²² të pretenduar nga subjekti si të vëllait, ky i fundit nuk figuron as si bashkëkredimarrës, as si dorëzanës.

84. Në lidhje me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të pabazuar të analizës financiare të kryer nga Komisioni, me pretendimin se është e paqartë pse analiza financiare nga ana e Komisionit për çdo rast është bërë për dy apo tre muaj të vitit, kur viti ka 12 muaj, trupi gjykues pasi kontrolloi vendimin e Komisionit mbi bazën e këtij shkak ankimi konstatoi se analiza financiare e kryer nga Komisioni lidhur me verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj për kryerjen e pagesave gjatë vitit 2009 dhe 2010 për likuidimin e çmimit të kësaj pasurie prej 220.000 eurosh, si me të drejtë konkluduar nga Komisioni sipas kontratës së porosisë së datës 05.08.2009, rezulton të jetë kryer mbi bazën e një analizë të ardhurash dhe shpenzimesh përkatësisht për periudhat 01.01.2009 - 31.12.2009²³ dhe 01.01.2010 – 31.12.2010²⁴. Në kuptim të sa më sipër konstatuar, pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar në fakte. Përpos sa më sipër, trupi gjykues pasi verifikoi deklaratat periodike të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj si dhe konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar pakësim të kursimeve *cash* për vitet 2009 dhe 2010, kur janë kryer pagesat për likuidimin e çmimit të pasurisë së paluajtshme objekt kontrolli, gjeti të drejtë dhe të bazuar në fakte kryerjen e analizës financiare nga ana e Komisionit bazuar vetëm në të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit të saj të realizuara brenda viteve objekt kontrolli.
85. Bazuar në sa më sipër, nga kontrolli i kryer nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor të analizës financiare të Komisionit për vitet 2009 dhe 2010, si paraqitur në vendimin objekt ankimi në tabelat

²⁰ Shkresa kthim përgjigje e Raiffeisen Bank, nr. {***} prot., datë 29.01.2020.

²¹ Z. P. K. është ortak dhe administrator i vetëm i shoqërisë “{***}” ShPK. Në këtë kontratë ka nënshkruar si hipotekues pasi ka ofruar pronën e tij “apartament me sipërfaqe 134,2 m², me nr. pasurie {***}”, si garanci për kredinë e marrë nga subjekti dhe bashkëshorti i saj.

²² Bashkëlidhur kontratës së kredisë, Raiffeisen Bank ka përcjellë edhe kontratën e porosisë, datë 05.08.2009, me shoqërinë “{***}” ShPK, për porositjen e pasurisë së paluajtshme të llojit “njësi” me çmimin 220.000 euro.

²³ Shih tabelën nr. 8 në faqen 34 të vendimit të Komisionit objekt ankimi.

²⁴ Shih tabelën nr. 9 në faqen 35 të vendimit të Komisionit objekt ankimi.

nr. 8 dhe 9, rezultoi se për pagesat e kështit të parë dhe të dytë, të kryera gjatë vitit 2009 në shumën totale prej 80.000 eurosh, subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 11.063.111²⁵ lekë për kryerjen e këtyre pagesave dhe mbulimin e shpenzimeve të kryera. Po ashtu, për pagesat e kështit të tretë dhe të katërt, të kryera gjatë vitit 2010 në shumën totale prej 120.000 euro, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të rezultuan me mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën (-) 6.245.124 lekë për kryerjen e pagesave dhe mbulimin e shpenzimeve gjatë vitit 2010.

86. Në përfundim të analizës së mësipërme, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të edhe pas kontrollit të ushtruar në Kolegj mbi bazën e shkaqeve të paraqitura në ankimi, nuk arritën të cenojnë konkluzionet e Komisionit se përveçse me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, janë ndodhur edhe në kushtet e fshehjes së pasurisë së paluajtshme të llojit “njësi” me sipërfaqe 124 m², me vendndodhje në rrugën “{****}”, Tiranë, porositur në vitin 2009 nga personi tjetër i lidhur A. Ç. (vëllai i subjektit të rivlerësimit), në shumën prej 220.000 eurosh dhe shlyer pagesat në vitet 2009 dhe 2010, nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj K. Dh., në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronjat “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016.
87. Lidhur me llogarinë bankare dyemërore (M. Ç. dhe K. Dh.), për të cilën Komisioni ka arritur në përfundim se nuk provohet ligjshmëria e burimeve financiare, të cilat kanë shërbyer për krijimin e fondeve në këtë llogari bankare dyemërore, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar si të paligjshme hapjen e kësaj llogarie nga banka. Në mbështetje të këtij shkak, subjekti i rivlerësimit pretendoi se në praktikën e bankës nuk ka asnjë autorizim prej saj dhe bashkëshortit të saj për fëmijën e tyre të mitur dhe as ndonjë certifikatë familjare apo të trungut që të provojë lidhjen mes dy llogarimbajtëseve, ndërkohë që nuk rezultoi që këtë paligjshmëri të pretenduar nga ana e bankës ta ketë adresuar në rrugë ligjore²⁶.
88. Në kuadër të këtij shkak ankimi, pasi verifikoi se kjo llogari dyemërore në emër të nënës dhe fëmijës së mitur të subjektit të rivlerësimit nuk ka qenë aktive në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, dhe se nga kontrolli i ushtruar analizës së Komisionit, nuk rezultoi që kjo shumë të ketë dhënë ndonjë pasojë financiare në ekonominë familjare të subjektit të rivlerësimit në vitin e krijimit të kësaj pasurie apo të ketë shërbyer si burim krijimi për pasuritë e subjektit dhe personit të lidhur pas tërheqjes së kësaj shume në datën e mbylljes së llogarisë 06.05.2014, trupi gjykues vlerësoi se në këtë rast nuk ndodhemi as para problematikave lidhur me kriterin e vlerësimit të saktësisë dhe plotësisë së deklaramit, dhe as në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme të pasurive objekt deklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting*. Për rrjedhojë,

²⁵ Diferenca rezultoi më e ulët se ajo e konstatuar nga Komisioni, për shkak të aplikimit të kursit të këmbimit sipas publikimeve të Bankës së Shqipërisë për periudhën përkatëse.

²⁶ Në përgjigje të pyetjes 24 të pyetësorit nr. 2, subjekti është shprehur: “Po si mund të deklaronim diçka për të cilën nuk ishim në dijeni. Për këtë është bërë dhe kallëzim penal dhe është provuar gjatë hetimit që ne si bashkëshortë nuk kishim asnjë dijeni për këtë depozitë. Banka nuk disponon asnjë autorizim për hapje depozite dhe asnjë certifikatë familjare për këtë depozitë. Pas kallëzimit penal nëna ime e ka tërhequr shumën e kësaj depozite. Nuk i bëmë kallëzim penal BKT-së se nuk besojmë te drejtësia kur të paditur janë bankat”.

problematikat e vërejtura gjatë hetimit të Komisionit lidhur me këtë llogari bankare dyemërore, nuk janë të atilla që të prodhojnë pasoja në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke u çmuar nga trupi gjykues pa peshë në vlerësimin e kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

89. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament” me sipërfaqe 92 m² në Golem, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2018, si “ende e paregjistruar në emrin tim dhe të bashkëshortit, fituar me testament nga babai im Sh. Ç., kjo e provuar me vendimin për lëshim të dëshmisë testamentare me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.03.2018”, Komisioni në vendim nuk duket të ketë mbajtur ndonjë qëndrim lidhur me vlerësimin e kësaj pasurie, por qëndrimin e subjektit të rivlerësimit ndaj kërkesave të Komisionit në lidhje me këtë pasuri e ka çmuar në drejtim të gatishmërisë për bashkëpunim, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar mungesën e bashkëpunimit të plotë me këtë institucion, në kundërshtim me dispozitën e nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.
90. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit të shprehura në ankim se lidhur me këtë pasuri ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e duhur në formën e kërkuar nga ligji në ILDKPKI së bashku me deklaratën *vetting* çmohen të pabazuara, pasi për shkak të momentit të deklarimit të kësaj pasurie për herë të parë në ILDKPKI, në datën 29.03.2019, asnjë dokumentacion lidhur me këtë pasuri nuk mund të jetë dhe nuk është dorëzuar në ILDKPKI së bashku me deklaratën *vetting*, e cila nuk ka asnjë deklaram lidhur me pasurinë në fjalë. Pavarësisht kësaj, trupi gjykues ndonëse e vlerëson si jobashkëpunues qëndrimin e subjektit të rivlerësimit ndaj kërkesave të Komisionit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, në kushtet kur në lidhje me këtë pasuri Komisioni nuk ka kryer hetim kryesisht dhe as është shprehur në vendim lidhur me arritjen e një konkluzioni për vlerësimin e saj, vlerësoi të mos i atribuojë subjektit të rivlerësimit në këtë rast pasojën juridike të të qenit “jobashkëpunuese” në kuadër të parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.
91. Lidhur me shtetasit e paraqitur si persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. Klorinda Çela në kuptim të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, kjo e fundit është shprehur në ankimin e saj se: (i) Shtetasi A. M., president i Kompanisë {***}, dhe shtetasi E. Z. janë miq të afërt të familjes të cilët kanë punuar me bashkëshortin në Universitetin {***}. (ii) Shtetasi R. H., sipas saj, nuk ka qenë dhurues por përfaqësues në marrëdhënien me bashkëshortin e saj. (iii) Shtetasi F. E. i cili ka qenë mik me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, sipas saj, ka bërë herë pas here pagesën e këstit të kredisë në llogarinë e tyre dhe se me këtë shtetas as subjekti dhe as bashkëshorti nuk kanë pasur gjykime ku ky person të ketë qenë i përfshirë. (iv) Shtetasit e tjerë, M. Ç., E. M., F. M., H. M., sipas subjektit, janë punonjës të kompanisë së nënës së subjektit të rivlerësimit, znj. M. Ç., në të cilën ka qenë pjesëtar edhe vëllai A. Ç., të cilit i ka kërkuar të paguajë këstin e kredisë dhe ky i fundit ua ka deleguar këtë punonjësve të tjerë. Subjekti shprehet se këta persona nuk i njeh dhe nuk ka pasur asnjëherë gjykime për çështje ku ata të kenë qenë palë. (v) Në lidhje me shtetasit B. S. dhe H. B., subjekti shprehet se nuk i njeh, por, referuar bashkëshortit të saj, ata kanë qenë punonjës të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër si shofer dhe ftues dhe kanë paguar këstet e kredisë, pasi u është kërkuar nga bashkëshorti i saj në kohën kur ka

punuar si gjyqtar pranë kësaj gjykate. Ajo shprehet se nuk kanë pasur asnjëherë gjykime ku këta persona të kenë qenë palë.

92. Trupi gjykues, pasi verifikoi hetimin e kryer nga ana e Komisionit lidhur me dhurimet, huatë, sponsorizimet/ndihmat financiare, shpërblimet etj., konkretisht: (i) dhuratën nga prindërit e subjektit në shumën 400.000 lekë, në vitin 2007; (ii) huanë në shumën 10.000 euro nga shtetasi E. Z.; (iii) huanë në shumën 6.000 euro nga shtetasi V. Dh.; (iv) sponsorizimet, shpërblimet dhe dhurimet nga shtetasi A. M., në shumën 64.300 euro; (v) sponsorizimin në shumën 150.000 lekë nga shtetasi Xh. H. për botim libri të bashkëshortit; si dhe shqyrtoi dokumentacionin e administruar në fashikullin e Komisionit lidhur me këtë pjesë të hetimit, në konsideratë të shpjegimeve dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit në Komision si dhe në ankim, si më sipër pasqyruar në paragrafin pararendës, vlerësoi të drejtë konkluzionin e Komisionit se, në referim të pikës 14 të nenit 3 dhe të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, shtetasit e cituar në këtë paragraf bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast të provojnë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumave të pretenduara si të dhëna hua, dhuruara apo të dhëna në formë shpërblimesh e sponsorizimesh.

93. Lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme të këtyre personave, referuar akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, në kuadër të kontrollit të saktësisë së konkluzionit të këtij të fundit, se nuk u arrit të provohen me dokumentacion justifikues burimet e të ardhurave të personave të sipërcituar, për efekt të justifikimit të shumave të dhuruara, sponsorizuara etj, trupi gjykues, pasi mori në analizë aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi dhe vlerësoi si vijon:

93.1. *Lidhur me dhuratën nga prindërit e subjektit në shumën 400.000 lekë, në vitin 2007, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion justifikues për të provuar mundësinë financiare të prindërve për të kursyer shumën e dhënë si dhuratë. I vetmi dokumentacion i administruar në fashikullin e bashkëshortit të subjektit K. Dh. (pjesë integrale e fashikullit të çështjes), është vërtetimi nr. {***} prot., datë 08.02.2021 nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Referuar kësaj shkrese, rezultoi se z. Sh. Ç. (babai i subjektit) ka përfituar pension pleqërie në masën mujore përfundimtare 15.152 lekë nga janar 2003 - janar 2016, ndërsa znj. M. Ç. ka përfituar pension pleqërie në masën mujore aktuale 10.385 lekë nga janari 2002 e në vazhdim. Bazuar në këto të dhëna, rezultoi se nga janari 2002 deri në fund të vitit 2007, prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur 1.656.840 lekë të ardhura.*

93.2. Nëse nga këto të ardhura do të zbriteshin shpenzimet e jetesës për dy persona, të përlllogaritura në masën 1.247.589 lekë për të gjithë periudhën, prindërit e subjektit të rivlerësimit do kishin mundësi të kursenin 409.251 lekë, duke justifikuar në këtë mënyrë me burime të ligjshme dhurimin objekt kontrolli. Përfshirja e kësaj shume në mesin e të ardhurave të ligjshme në analizën financiare për vitin 2007, do të sillte përmirësimin e balancës negative nga (-) 1.487.115 lekë në (-) 1.087.115 lekë.

93.3. *Lidhur me huanë në shumën 10.000 euro nga shtetasi E. Z. në vitin 2012, nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë bankare në euro të z. K. Dh. pranë Tirana Bank ShA, rezultoi se subjekti ka arkëtuar cash shumën prej 17.300 eurosh, me përshkrimin “ndihmë nga të afërm për mbyllje totale të kredisë”, shumë e cila është përdorur në të njëjtën ditë për likuidimin e plotë të kredisë së marrë në datë 22.05.2005 për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 114,6 m², në rr. “{***}”, Tiranë, në përputhje me deklaratimet e subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting*. Trupi gjykues konstaton se nga hetimi administrativ, nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë lidhur me marrjen e huasë nëpërmjet transaksioneve bankare sikundër dhe subjekti nuk rezulton të ketë paraqitur dokumentacion provues mbi mundësinë financiare të huadhënësit për krijimin e shumës së dhënë hua, pavarësisht deklaratimit se ky i fundit ka qenë i punësuar pranë shoqërisë “{***}”. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur kanë dështuar të përmbushin detyrimin ligjor sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 për justifikimin me burime të ligjshme të shumës prej 10.000 eurosh, të pretenduar si hua nga shtetasi E. Z..*

93.4. *Lidhur me huanë në shumën 6.000 euro, nga shtetasi V. Dh. (vjeherri i subjektit) në vitin 2012, e cila është pretenduar si e përdorur nga subjekti si pjesë e shumës së arkëtuar cash prej 17.300 eurosh me përshkrimin “ndihmë nga të afërm për mbyllje totale të kredisë” me qëllim likuidimin e vlerës totale të kredisë së marrë pranë kësaj Tirana Bank, si deklaruar edhe në deklaratën e pasurisë, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion justifikues për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së marrë hua nga vjeherri i saj z. V. Dh.. Edhe në këtë rast i vetmi dokumentacion i administruar në fashikullin e çështjes është vërtetimi nr. {***} prot., datë 08.02.2021, i Institutit të Sigurimeve Shoqërore (pjesë e fashikullit të z. K. Dh.). Referuar këtyre të dhënave rezulton se z. V. Dh. duke filluar nga muaji gusht 1990 ka përfituar pension pleqërie në masën mujore 29.309 lekë.*

93.5. *Nga analizimi i këtyre të dhënave do të rezultonte se deri në janar të vitit 2012, kur pretendohet të jetë dhënë huaja bashkëshortit të subjektit në shumën 6.000 euro, z. V. Dh. ka përfituar 7.532.413 lekë të ardhura nga pensioni, nga të cilat nëse do të zbrisnim shpenzimet e jetesës për një person të përlllogaritura sipas standardit të aplikuar në Kolegj në shumën 3.685.019 lekë, do të rezultonte që ky i fundit kishte mundësi që me të ardhura të ligjshme ta justifikonte krijimin e shumës së huasë prej 6.000 eurosh. Përfshirja e kësaj shume në analizën financiare për vitin 2012 do të sillte një reduktim të balancës negative nga (-) 5.549.290 lekë në (-) 4.721.290 lekë.*

93.6. *Lidhur me sponsorizimet, shpërblimet dhe dhurimet nga shtetasi A. M. në shumën 64.300 euro, në periudhën 2008-2013, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion justifikues për të provuar burimin e krijimit të kësaj shume të dhënë nga z. A. M.. Nga të dhënat e administruara nga komunikimi i Komisionit me Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj²⁷ rezulton se shtetasi në fjalë është referuar si një ndër aksionarët e shoqërisë “{***}” Sh.P.K. Sipas së njëjtës shkresë, evidentohet se për periudhën 2009-2014 kjo shoqëri ka deklaruar*

²⁷ Referuar shkresës kthim përgjigje të, z. A. M. nr. {***} datë 19.03.2020

humbje në çdo vit dhe nuk ka raportuar dividend të shpërndarë. Bazuar në këto të dhëna të rezultuara gjatë hetimit administrativ dhe në mungesë të dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, kjo e fundit dhe personi tjetër i lidhur, z. A. M. ndodhen në kushtet e mosjustifikimit me burime të ligjshme financiare të shumës së sponsorizuar/dhuruar prej 64.300 euro, në kuptim të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

93.7. Lidhur me sponsorizimin në shumën 150.000 lekë nga shtetasi Xh. H. për botim libri të bashkëshortit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi mospërputhje në deklaratimet e subjektit dhe deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.10.2016 të depozituar në mbështetje të pretendimit për sponsorizimin e dhënë nga shtetasi Xh. H. në favor të bashkëshortit të subjektit. Sipas deklaratës noteriale të sipërcituar, shtetasi Xh. H. deklaroi se në vitin 2004 i ka dhënë në formë sponsorizimi për botimin e librit “Fjalor italisht – shqip – italisht” shumën prej 150.000 lekësh shtetasit D. A. dhe jo bashkëshortit të subjektit z. K. Dh.. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur kanë dështuar të përmbushin detyrimin ligjor sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 për justifikimin me burime të ligjshme të shumës prej 150.000 lekësh të pretenduar si sponsorizim nga shtetasi Xh. H..

- 94.** Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, nga kontrolli i ushtruar në Kolegj, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, analizës financiare të Komisionit për periudhën e vlerësimit 2003-2016, mbi bazën e shkaqeve të ankimit, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, rezultuan me mungesë të të ardhurave të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera në vitet 2004, 2005, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2014, 2015 dhe 2016 respektivisht në shumat (-) 451.890 lekë, (-) 1.177.952 lekë, (-) 1.087.115 lekë, (-) 1.291.532 lekë, (-) 11.498.687 lekë, (-) 6.245.124 lekë, (-) 7.911.770 lekë, (-) 4.721.290 lekë, (-) 1.014.661 lekë, (-) 15.372.748 lekë dhe (-) 3.520.498 lekë, në total me balancë negative për gjithë periudhën e rivlerësimit 2003 – 2016, në shumën prej (-) 54.293.265 lekësh.
- 95.** Në vijim të konkluzioneve të mësipërme, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm të kriterit të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, në konsideratë edhe të konkluzioneve të tjera të Komisionit në çështje, për të cilat subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shkaqe në ankimin e saj, duke i konfirmuar ato, bazuar në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 33, pika 5, shkronjat “b” e “c”, si dhe 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, për pasojë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 464, datë 28.10.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Klorinda Çela.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall më datë 30.01.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi